



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 48/2020 Regjistri (JR)
Datë 10.11.2020

Nr. 44 i vendimit
Datë 16.11.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Rezarta Schuetz	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 16.11.2022, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar z. Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Aliaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

OBJEKT: Shqyrtimi i vendimit nr. 260, datë 15.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe

pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 260, datë 15.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Aliaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Aliaj, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konstatuar se:

- *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë vendimin nr. 260, datë 15.06.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 260, datë 15.06.2020, vendosi: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Aliaj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë [...]*”. Ky vendim u mor bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pikat 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016, mbi bazën e konkluzioneve të mëposhtme.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, në referim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

¹ ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.07.2018, ka përcjellë pranë Komisionit raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Aliaj.

Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të tij, në referim të nenit D, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës.

Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

Bazuar në paragrafin 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia, pasi ka përdorur funksionin e tij si magjistrat dhe ka shfrytëzuar dhënien e një vendimi gjyqësor për të bërë të mundur regjistrimin e pasurisë së palës ndërgjyqëse, pjesë nga e cila posedonte edhe vetë, si dhe për qasjen e sjelljen e tij ndaj procesit të rivlerësimit.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 260, datë 15.06.2020, të Komisionit, ushtroi ankim² subjekti i rivlerësimit në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore³.
6. Në ankimin e datës 16.10.2020 dhe në parashtrimet para zhvillimit të seancës gjyqësore, të dorëzuara në rrugë postare në Kolegj në datën 09.11.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji, riçeljen e hetimit gjyqësor për tri kriteret e rivlerësimit (pasuri, figurë dhe aftësi profesionale), marrjen dhe administrimin e provave bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve, prishjen e vendimit nr. 260, datë 15.06.2020, të Komisionit dhe kthimin e çështjes për rigjykim ose ndryshimin e vendimit nr. 260, datë 15.06.2020, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të tij.
7. Nga shqyrtimi tërësor i ankimit dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 260, datë 15.06.2020, shkaqet e ankimit janë evidentuar në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

A. Shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe anën procedurale të procesit të rivlerësimit

7.1 Vendimi i dhënë nga Komisioni është rezultat i shkeljes flagrante dhe i cenimit të parimit se çdo subjekti duhet t'i mundësohet e drejta për një proces të drejtë ligjor, garantuar ky parim nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "KEDNj").

7.2 Vendimmarrja e Komisionit është rezultat i cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe parimit të barazisë së armëve, duke i cenuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për akses, të drejtën për të qenë prezent në seancë, për të parashtruar pretendimet, si dhe për t'u mbrojtur, duke e mbështetur mbrojtjen në prova.

7.3 Koha e vënë në dispozicion nga Komisioni ka qenë e pamjaftueshme dhe vendimi i ndërmjetëm i datës 03.03.2020, për rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e afatit për të paraqitur prova, si dhe vendimi tjetër i ndërmjetëm i datës 10.06.2020, që ka konfirmuar këtë vendim, është i njëanshëm dhe i gabuar.

² Ankimi është regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 16.10.2020.

³ Vendimi nr. {***}, datë 16.10.2020, i Komisionit ka pranuar ankimin e paraqitur dhe ka njoftuar rregullisht subjektin e rivlerësimit.

7.4 Procesi ndaj subjektit të rivlerësimit ka qenë i paragjykuar, pasi megjithëse subjekti ka paraqitur raport shëndetësor, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë duke caktuar datën 15.06.2020, si datën e shpalljes së vendimit ndaj tij, duke cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar, mbrojtur, si dhe për të paraqitur prova për të provuar të kundërtën e konkluzioneve të tyre.

7.5 Vendimi i Komisionit është rezultat i shkeljes së dy elementëve thelbësorë të së drejtës për një proces gjyqësor të drejtë, sikundër janë pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës.

7.6 Subjekti i rivlerësimit e kundërshton si të gabuar konkluzionin e Komisionit se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi ai është shprehur i gatshëm për të vënë në dispozicion të Komisionit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, përveç rasteve kur nuk ka qenë e mundur për arsye objektive. Komisioni ka cenuar procesin e rregullt ligjor dhe pamundësia e tij objektive për t'u paraqitur në seancën dëgjimore është e mbështetur në prova shkresore.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur konsistojnë, në sa vijon:

7.7 Lidhur me pasurinë banesë private e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë, me sipërfaqe ndërtimi 105 m² e ndërtuar mbi tokën me sipërfaqe 200 m², ndodhur në lagjen nr. {***}, Sarandë, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të ndërtimit të kësaj pasurie në vitin 2004, pasi sipas tij për ndërtimin e saj ka shërbyer huaja e marrë në shumën 25 milion dhrahmi greke në vitin 2000 nga shtetasi P. K..

7.8 Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka gabuar duke mos i marrë në konsideratë shumën prej 48.000 dollarë amerikanë, përfituar nga ushtrimi i profesionit të konsulentit juridik-avokat nga datat 03.01.2005 – 04.03.2006, shumën prej 25.000 dollarë amerikanë dhënë hua nga i ati dhe shumën prej 15.000 dollarë amerikanë dhënë nga vëllai i tij, të ardhura këto, që sipas tij kanë shërbyer për shlyerjen e huas prej 25 milion dhrahmi greke ndër vite.

7.9 Lidhur me burimin e të ardhurave për pasurinë truall me sipërfaqe 200 m², ndodhur në lagjen nr. {***}, Sarandë, mbi të cilën është ndërtuar banesë private me sipërfaqe ndërtimi 105 m², subjekti i rivlerësimit pretendon se ka shërbyer huaja e marrë nga vëllai i tij Xh. A., i cili i ka të ardhurat e siguruara nga puna në emigracion. Sipas subjektit, nuk qëndron konkluzioni i Komisionit se gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, lidhur me përfitimin e truallit me sipërfaqe 200 m², pasi vendimmarrja e subjektit, në cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues për këtë pasuri, është pas lidhjes së kontratës së shitblerjes së truallit.

7.10 Konkluzionin e Komisionit se shuma prej 2.700.000 lekësh, e përfituar nga shitja e shtëpisë në Delvinë, nuk mund të ketë shërbyer si burim kryesor i krijimit të depozitës në shumën 3.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit e vlerëson të gabuar, pasi, fakti që ka provuar pagimin e tatimit për kontratën e shitjes së shtëpisë në Delvinë konform legjislacionit në fuqi, vërteton se këto të ardhura janë burim i ligjshëm i krijimit të depozitës bankare në Bankën e Shqipërisë si bono thesari.

7.11 Subjekti i rivlerësimit e konsideron të pabazuar qëndrimin e Komisionit se nuk justifikon me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit tip “MNV Pajero Mitsubishi” në pronësi të L. A., pasi

shuma prej 7.500 eurosh është përfituar nga punësimi në Greqi i djalit të tij dhe konfirmohet nga deklarata e datës 06.12.2015 e shtetasit A. M. (punëdhënësit të djalit të tij).

7.12 Subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar konkluzionin e Komisionit se ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e shkollimit të vajzave të tij, pasi shpenzimet e shkollimit të vajzës R. A. janë mbuluar nga punësimi i saj në ShBA, si dhe me ndihmën e xhaxhait të subjektit, z. S. A., ndërsa për shpenzimet e shkollimit të vajzës M. A. ka shërbyer huaja e marrë në vitin 2016, në vlerën 25.000 euro nga shtetasit N dhe M. P., si dhe dhurimi në shumën 14.000 USD nga shtetasi A. B. Xh..

7.13 Lidhur me denoncimet e ardhura në Komision, subjekti i rivlerësimit pretendon se me shtetasin B. S. është në armiqësi që nga viti 2002, fakt i ditur publikisht nga të gjithë, të cilin ia ka bërë të ditur edhe Komisionit. Ndërsa me shtetasin K. N. është në konflikt interesi, pasi ky shtetas ka qenë palë në gjykim në një çështje gjyqësore, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e relatorit.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

8. Ankimi i subjektit të rivlerësimit, ndaj vendimit nr. 260, datë 15.06.2020, të Komisionit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”).
9. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur ndaj vendimit të Komisionit ushtrohet ankim nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, konstaton se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, si dhe vendos për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve.
10. Me ankimin dhe parashtrimet, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte dhe dokumente në cilësinë e provave të reja, për të cilat trupi gjykues vlerëson se nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke refuzuar marrjen e tyre, bazuar në nenin 49, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, me arsyetimin si më poshtë.

10.1. Për aktet: (1) vendim nr. 127, datë 10.03.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor; (2) urdhër i Kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë, datë 10.03.2020, për pezullimin e veprimtarisë së gjykatave për shkak të situatës së krijuar në vend nga Covid-19; (3) urdhër i Kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë, datë 24.03.2020, për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe veprimeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Vlorë, për shkak të situatës së krijuar në vend nga Covid-19; (4) shkresë nr. {***} prot., datë 08.06.2020, e Kancelares së Gjykatës së Apelit Vlorë; (5) shkresë “kthim përgjigje”, datë 11.06.2020, e Kryetares së degës së buxhetit të Gjykatës së Apelit Vlorë; (6) shkresë “për dijeni”, datë 29.04.2020, gjyqtarit Petrit Aliaj, procesverbalet administrativ, datë 11.03.2020, të mbajtura nga sekretaria gjyqësore (5 copë) që u përkasin çështjeve të gjyqtarit Petrit Aliaj; (7) fletëdalje, datë 12.03.2020, të spitalit “{***}”, Tiranë; (8) raport për paaftësi të përkohshme në punë të spitalit “{***}”, Tiranë, datë 12.03.2020, mbi dhënien e 10 (dhjetë) ditë pushim nga data 10.03.2020 – 20.03.2020; si dhe (9) raport për paaftësi të përkohshme në punë, datë 15.06.2020, i Institutit Shëndetësor Sarandë, trupi gjykues konstaton se janë akte të paraqitura nga subjekti i

rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision dhe referojnë fakte të njohura nga Komisioni. Për këto arsye, këto akte përjashtohen nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre në zgjidhjen e çështjes dhe refuzohen të merren si prova, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016⁴.

10.2. Për sa i përket akteve: (1) shkresë nr. {***} prot., datë 19.06.2020, e Kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë; (2) vërtetime për periudhat tatimore 2008, 2009 dhe 2010 të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Greqisë me vulë apostile; (3) vendim gjyqësor nr. {***}, datë 08.07.2014, i Gjykatës së Apelit Vlorë; (4) fotokopje e pasaportës së vajzës R. A., për vizat e marra gjatë viteve 2004, 2005, 2006 dhe 2007; (5) fotokopje e pasaportës së djalit L. A. për vizat e marra nga gjatë vitit 2008; si dhe (6) vërtetim nr. {***} prot., datë 13.06.2019, i Sigurimeve Shoqërore Sarandë, trupi gjykues çmon se dokumentet e sipërcituara nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas dhënies së vendimit të Komisionit, si rrjedhojë, paraqitja e tyre në këtë fazë nuk plotëson kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit provat e reja në ankim mund të paraqiten vetëm në kushtet kur ankuesi provon pamundësinë për t’i paraqitur ato në shqyrtimin në shkallë të parë. Gjithashtu, këto akte nuk përmbajnë informacion të ri, mbi të cilën do të provohej diçka ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, për pasojë trupi gjykues çmon se është e panevojshme marrja e këtyre akteve në cilësinë e provës dhe bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016⁵, refuzohet marrja e tyre nga Kolegji.

10.3. Lidhur me aktet⁶ e paraqitura me parashtrimet, trupi gjykues vlerëson se nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, sipas së cilave deri pesë ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim, por jo prova të reja, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe, për këto arsye, përjashtohen nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

- 11.** Në lidhje me procesin e rregullt ligjor dhe anën procedurale të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i dhënë nga Komisioni është rezultat i shkeljes flagrante dhe i cenimit të parimit se *çdo subjekti duhet t’i mundësohet e drejta për një proces të drejtë ligjor*, garantuar ky parim nga Kushtetuta dhe KEDNj-ja, pasi:

⁴ Neni 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit [...]”.

⁵ Neni 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] a) marrja e provës duket se është e panevojshme; [...]”.

⁶ Vendim, datë 16.06.2022, për mosfillimin e procedimit pasuror të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë.

Vërtetim i Dhomës Vendore të Avokatisë Vlorë, datë 10.09.2021.

Dokumenti, datë 02.10.2019, deklaratë me përgjegjësi e shtetasit grek N. S., lidhur me të ardhurat e punës së shtetasit Xh. A, me vulë apostile të shtetit grek.

- i. Vendimmarrja e Komisionit është rezultat i cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe parimit të barazisë së armëve, duke i cenuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për akses, të drejtën për të qenë prezent në seancë, për të parashtruar pretendimet, si dhe të drejtën për t’u mbrojtur, duke e mbështetur mbrojtjen në prova.
- ii. Seanca dëgjimore në Komision është zhvilluar pa praninë e subjektit të rivlerësimit edhe pse ky i fundit në datat e njoftuara nga Komisioni për zhvillimin e saj ka paraqitur raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë, i cili përbën akt zyrtar me vlerën e provës dhe konsiderohet i vlefshëm derisa nuk provohet falsiteti i tij. Paraqitja e raportit mjekësor përbën shkak të ligjshëm për shtyrjen e seancës dëgjimore.
- iii. Vendimi i ndërmjetëm i Komisionit, datë 05.06.2020, i ka mohuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe është bazuar në konkluzione të gabuara, të njëanshme dhe të pavërteta, të mbështetura vetëm në shkresën nr. {***} prot., datë 04.05.2020, e KLGj-së dhe shkresën e kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë, faktet e të cilave bien ndesh me aktet shkresore, të cilat i janë vendosur në dispozicion subjektit po nga ajo gjykatë. Komisioni kishte detyrimin ligjor të kryente të gjitha verifikimet e duhura në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe në institucionin shëndetësor, në të cilin kishte marrë mjekimin subjekti i rivlerësimit, për të mos vepruar në mënyrë të njëanshme si në rastin konkret.
- iv. Në kushtet kur subjekti e kishte të pamundur nga ana shëndetësore për t’u paraqitur në seancën dëgjimore të datës 05.06.2020, Komisioni kishte detyrimin t’i caktonte një përfaqësues të caktuar kryesisht, sipas parashikimit ligjor të nenit 36/3, shkronja “e” të Kodit të Procedurave Administrative.
- v. Procesi ndaj subjektit të rivlerësimit ka qenë i paragjykuar nga ana e Komisionit, pasi megjithëse subjekti i rivlerësimit ka paraqitur raport shëndetësor, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë, duke caktuar datën 15.06.2020, si datën e shpalljes së vendimit ndaj tij, duke cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, si dhe për të paraqitur prova për të provuar të kundërtën e konkluzioneve të tyre, kështu vijimi i gjyqimit pa prezencën e subjektit të rivlerësimit përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor siç ka konstatuar Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁷.

11.1. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjyqësor shqyrtoi aktet e ndodhura në fashikujt e përcjellë nga Komisioni nga ku konstaton se:

- i. Komisioni në datën 28.02.2020 ka ftuar subjektin e rivlerësimit për t’u dëgjuar në seancën dëgjimore, e cila do të zhvillohej në datën 05.03.2020, duke i dhënë të drejtën të paraqesë prova dhe shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit deri ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore.
- ii. Subjekti i rivlerësimit në datën 04.03.2020, paraqiti në Komision kërkesën për kohë shtesë për paraqitjen e provave, disa akte, si dhe kërkesën për shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 05.03.2020, pasi e kishte të pamundur nga ana shëndetësore, duke depozituar raportin⁸ për paaftësi të përkohshme në punë.

⁷ Në çështjen “P/C dhe S kundër Mbretërisë së Bashkuar”, çështjen “Kronbach kundër Francës”, çështja “Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar” (28.06.1984) kërkesa nr.7819/77 dhe 7878/77), çështjen “Rachdad kundër Francës”.

⁸ Raport mjekësor nr. {***} regj., lëshuar nga Spitali Rajonal Vlorë, me diagnozën “gjendje febrile”, pushim tri ditë, prej datës 04.03.2020 – 06.03.2020.

- iii. Komisioni, pasi u njoh me pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për t'u paraqitur në seancën dëgjimore të datës 05.03.2020, për arsye shëndetësore, sipas raportit për paaftësi të përkohshme, depozituar elektronikisht dhe në protokollin e Komisionit, vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore në datën 09.03.2020, ora 14:15, duke e njoftuar subjektin nëpërmjet postës elektronike në datën 04.03.2020.
- iv. Në datën 09.03.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komisionin kërkesën për revokimin e vendimit të ndërmjetëm të datës 03.03.2020, të Komisionit, kërkesë për riçelje të hetimit administrativ edhe për dy kritere të tjera, të figurës dhe aftësisë profesionale, si dhe kërkesën për shtyrje të seancës dëgjimore të datës 09.03.2020, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore⁹.
- v. Komisioni, pasi u njoh me këtë fakt, vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore të planifikuar për në datën 11.03.2020, duke i bërë me dije subjektit të rivlerësimit që, nëse nuk mund të paraqitej në seancën vijuese dëgjimore për arsye shëndetësore, të merrte masat e duhura ligjore për delegimin e një përfaqësuesi ligjor për përfaqësimin dhe paraqitjen e shpjegimeve të tij në seancën e radhës.
- vi. Në datën 10.03.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti nëpërmjet postës elektronike raportin mjekësor¹⁰ lëshuar nga spitali “{***}”.
- vii. Me vendimin e ndërmjetëm, datë 11.03.2020, Komisioni vendosi pezullimin e seancës dëgjimore të planifikuar për t'u zhvilluar në datën 11.03.2020, me qëllim që të hetonte procedurat ligjore të ndjekura për lëshimin e raporteve, konkretisht t'i kërkonte Ministrisë së Shëndetësisë¹¹ ngritjen e një grupi mjekësh për të verifikuar ligjshmërinë e raporteve, si dhe t'i kërkonte Këshillit të Lartë Gjyqësor të marrë masa për ekzaminimin e subjektit të rivlerësimit nga një mjek i caktuar prej tyre.
- viii. Në përgjigje të kërkesës nr. {***}, datë 11.03.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor informon¹² Komisionin se ka kërkuar informacion pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për gjyqtarin Petrit Aliaj, mbi paraqitjen e tij në punë dhe vijueshmërinë e frekuentimit prej tij. Me shkresën nr. {***} prot., datë 29.04.2020, Kryetarja e Gjykatës Apelit Vlorë informon KLGJ-në se: “[...] gjyqtari i kësaj gjykate Petrit Aliaj nuk ka paraqitur raport për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën nga 11.03.2020 e deri në momentin e kthimit të përgjigjes. Gjithashtu, gjyqtari Petrit Aliaj është paraqitur në punë në mënyrë të pandërprerë gjatë kësaj periudhe dhe ka marrë pjesë në të gjitha gjykimet ku ka qenë relator apo anëtar i trupi gjyqësor [...]”.
- ix. Me e-mail-in e datës 29.05.2020, Komisioni njofton subjektin e rivlerësimit se seanca dëgjimore me të do të zhvillohet në datën 05.06.2020, ora 13:00. Në ditën e caktuar për zhvillimin e seancës së tij dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet e-mail-it njofton

⁹ Depozituar në datën 07.03.2020, raportin për paaftësi të përkohshme, lëshuar nga spitali “{***}”, me diagnozën “lumbago akute”, nga data 7.3.2020 – 9.3.2020. Komisioni nëpërmjet e-mail-it të datës 09.03.2020, ka kontaktuar me spitalin “{***}”, me qëllim verifikimin e raportit mjekësor të lëshuar nga ky institucion, i cili konfirmoi faktin se raporti mjekësor i datës 07.03.2020 është lëshuar nga mjekja E. K., pasi vetë pacienti është paraqitur dhe vizituar pranë këtij spitali.

¹⁰ Raport mjekësor, datë 10.03.2020, lëshuar nga spitali “{***}”, në të cilin citohej se pacienti ishte shtruar në datën 10.03.2020, me diagnozën “Hernie diskale hiperalgjike e spondiloartrozë”.

¹¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 11.03.2020, Komisioni i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, me qëllim auditimin e procedurave të ndjekura në lëshimin e raporteve mjekësore, caktimin e një grupi mjekësh për të verifikuar mënyrën e lëshimit të raporteve mjekësore për z. Petrit Aliaj për të konfirmuar vërtetësinë e tyre. Nga shqyrtimi i akteve në dosjen e përcjellë nga Komisioni nuk konstatohet kthim përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë.

¹² Shkresë nr. {***} prot., datë 04.05.2020, e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Komisionin se nuk mund të paraqitej në seancë, për arsye shëndetësore, duke bashkëlidhur raport për paaftësi të përkohshme në punë¹³.

- x. Komisioni, duke mbajtur në konsideratë se subjektit të rivlerësimit në mënyrë të përsëritur i ishte bërë me dije se nëse do të vijonte pamundësia e paraqitjes së tij personalisht në seancë për shkaqe shëndetësore, ai duhet të merrte masa për caktimin e një përfaqësuesi ligjor në seancë, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin e bërë të ditur nga KLGj-ja se ditën e seancës dëgjimore të datës 11.3.2020, e cila u shty për pamundësi objektive të subjektit, ky i fundit ishte paraqitur në vendin e tij të punës, vendosi të mos e shtynte më në vijim seancën dëgjimore, e cila u mbajt në datën e planifikuar më 05.06.2020, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hravtin.
- xi. Në datën 12.06.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca për shpalljen e vendimit do të zhvillohej në datën 15.06.2020, ora 13:15, në të njëjtin vend të njoftuar më parë. Nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 15.6.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti përsëri raport¹⁴ për paaftësi të përkohshme në punë.

11.2. Trupi gjykues i Kolegjit, referuar akteve të sipërcituara, vëren se në kushtet kur janë paraqitur një sërë raportesh mjekësore nga ana e subjektit të rivlerësimit Petrit Aliaj dhe, pikërisht në fazën e fundit të procesit të rivlerësimit, pra, në momentin që subjekti duhej të përballej me konkluzionet e Komisionit në seancën dëgjimore, konstaton se dukshëm ka pasur një tendencë të qëllimshme të subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e seancave dëgjimore të caktuara nga Komisioni¹⁵, duke paraqitur raporte mjekësore, pikërisht, ditën e zhvillimit të seancave të caktuara ndaj tij, si dhe duke mos marrë asnjë masë për të realizuar të drejtën e tij të mbrojtjes, në seancën dëgjimore¹⁶.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i ka garantuar subjektit të rivlerësimit të gjitha të drejtat për një proces të rregullt ligjor, duke marrë në konsideratë kërkesat e subjektit për shtyrjen e afatit kohor për paraqitjen e provave, duke marrë në shqyrtim të gjitha kërkesat procedurale të paraqitura gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe duke i bërë të ditur të drejtën e mbrojtjes me përfaqësues ligjor në seancën dëgjimore. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit ka paragjykuar vazhdimisht procesin e tij të rivlerësimit dhe anëtarët e trupës gjyquese, duke pasur si qëllim zvarritjen e këtij procesi, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk qëndrojnë.

¹³ Raport mjekësor nr. {***} regj., datë 05.06.2020, lëshuar nga Poliklinika e Specialiteteve Spitalit Rajonal Vlorë në të cilin i jepej 1(ditë) pushim.

¹⁴ Raport mjekësor nr. {***} regj., të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë me diagnozën “angina folikulare” pushim tri ditë, prej datës 15.6.2020 – 17.6.2020.

¹⁵ Komisioni ka pranuar të shtyjë seancat e datës 05.03.2020, 09.03.2020 dhe 11.03.2020, por ka refuzuar të shtyjë më tej seancën dëgjimore të datës 05.06.2020, megjithëse subjekti i rivlerësimit kishte paraqitur përsëri raport mjekësor, duke e zhvilluar seancën pa prezencën e tij. Gjithashtu, ka shpallur vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit me datën 15.06.2020, pa prezencën e subjektit të rivlerësimit, kur ky i fundit kishte paraqitur raport mjekësor.

¹⁶ Komisioni i ka bërë me dije subjektit të rivlerësimit fillimisht me e-mail-in e datës 11.03.2020 se “nëse nuk mund të paraqitej në seancën vijuese dëgjimore për arsye shëndetësore, të merrte masat e duhura ligjore për delegimin e një përfaqësuesi ligjor për përfaqësimin dhe paraqitjen e shpjegimeve të tij në seancën e radhës”.

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është rezultat i shkeljes së dy elementeve thelbësorë të së drejtës për një proces gjyqësor të drejtë, sikundër janë pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës pasi:

- i. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për rezultatet e hetimit administrativ nëpërmjet *e-mail*-it të datës 28.02.2020 dhe i është kaluar barra e provës për çështjet për të cilat duhej të paraqiste prova deri në datën 02.03.2020, në një kohë që pa përfunduar afati për paraqitjen e shpjegimeve përfundimtare, subjekti i rivlerësimit është njoftuar se në datën 05.03.2020, duhej të paraqitej në seancën dëgjimore publike. Ky njoftim i Komisionit nga ana e kësaj trupe gjykuese me veprime konkrete ka paragjykuar atë, duke cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t'u mbrojtur, si dhe për të paraqitur prova.
- ii. Koha e vënë në dispozicion nga trupi gjykues ka qenë e pamjaftueshme dhe vendimi i ndërmjetëm i datës 03.03.2020, i Komisionit, për rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, për shtyrje afati për të paraqitur prova, si dhe vendimi tjetër i ndërmjetëm i datës 10.06.2020, që ka konfirmuar këtë vendim, është i njëanshëm dhe i gabuar.
- iii. Gjithashtu, vendimi i ndërmjetëm i datës 10.03.2020, për rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit edhe për dy kritere të tjera, atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, ka paragjykuar procesin e tij të rivlerësimit, duke u fokusuar vetëm në një kriter atë të pasurisë, duke paravendosur përfundimin e procesit me disponimin për shkarkimin e tij.

12.1. Lidhur me këto pretendime të subjektit, referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se:

- i. Komisioni, me *e-mail*-in e datës 26.02.2019, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit mbi përbërjen e trupit gjykues, deklarimin e konfliktit të interesit, si dhe në zbatim të neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave, i ka kërkuar informacion, duke i drejtuar pyetjet bashkëlidhur *e-mail*-it.
- ii. Me *e-mail*-in e datës 09.09.2019, Komisioni i dërgoi subjektit të rivlerësimit pyetësorin me pyetjet shtesë duke i caktuar 10 ditë afat për dhënien e shpjegimeve. Subjekti i rivlerësimit me *e-mail*-in e datës 18.09.2019, drejtuar Komisionit kërkoi shtyrjen e afatit për paraqitjen e provave për shkak të pamundësisë për të siguruar në kohë marrjen e dokumentacionit për vajzën, e cila ndodhet ne ShBA, dokumentacionin nga shteti grek, si dhe përgjigjet nga disa institucione të Republikës së Shqipërisë, për të cilat subjekti i rivlerësimit kishte bërë kërkesë.
- iii. Me vendimin e datës 18.09.2019, Komisioni, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit dërguar në formë elektronike në datën 18.09.2019, vendosi shtyrjen e afatit për paraqitjen e provave të kërkuara deri në datën 30.09.2019.
- iv. Komisioni, me vendimin nr. {***}, datë 20.02.2020, vendosi të përfundojë hetimin administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe, po në të njëjtën ditë, i përcolli rezultatet e hetimit administrativ¹⁷, si dhe i caktoi si afat për dhënien e shpjegimeve dhe paraqitjen e kërkesave datën 02.03.2020.
- v. Subjekti i rivlerësimit, në datën 28.2.2020, kërkoi shtyrjen e afatit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit. Komisioni vlerësoi për t'i dhënë kohë shtesë subjektit

¹⁷ Njoftoi subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr.84/2016, duke i njohur të drejtën për t'u njohur me dosjen e procedurës së rivlerësimit, në përputhje me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurës Administrative.

për paraqitjen e shpjegimeve dhe provave deri në datën e zhvillimit të seancës dëgjimore, duke e njoftuar se ajo do të mbahej në datën 05.03.2020, ora 10:30.

- vi. Në datën 02.03.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti para Komisionit në formë elektronike shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, disa prova dhe kërkesën për shtyrje afati për shkak të pamundësisë për të siguruar provat. Subjekti i rivlerësimit depozitoi në protokollin e Komisionit aktet, të cilat ishin paraqitur edhe nëpërmjet komunikimit, me postën elektronike të datës 02.03.2020.
- vii. Me vendimin e ndërmjetëm, datë 03.03.2020, Komisioni vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për shtyrje afati për të paraqitur prova, me arsyetimin¹⁸ se i kishte bërë me dije subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ kërkesën për plotësimin e të njëjtave kërkesa, si dhe i kishte dhënë kohën e mjaftueshme për paraqitjen e tyre.
- viii. Në datën 09.03.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesë, për revokimin e vendimit të ndërmjetëm të datës 03.03.2020, të Komisionit, duke pretenduar se ky vendim kishte rrëzuar kërkesën e tij për marrjen e provave të reja, si dhe kërkesën për riçelje të hetimit administrativ edhe për dy kritere të tjera, të figurës dhe aftësitë profesionale. Komisioni mori në shqyrtim kërkesat e subjektit të datës 09.03.2020 dhe me vendimin¹⁹ e ndërmjetëm të datës 10.03.2020 vendosi mospranimin e tyre.
- ix. Në datën 02.06.2020, nëpërmjet komunikimit, në postën elektronike, subjekti riparaqiti kërkesë për riçelje hetimi për kriterin e pasurisë edhe për dy kriteret e tjera të vlerësimit, kontrollit të figurës dhe të vlerësimit profesional, si dhe kërkoi kohë për të paraqitur dokumentacionin që lidhet me punësimin e djalit L. A., në Greqi. Komisioni²⁰ e njoftoi

¹⁸ Komisioni konstatoi se në të ishin parashtruar kërkesa të cilave u ishte dhënë përgjigje nga trupi gjykues, me vendimin e ndërmjetëm të datës 03.03.2020, me përjashtim të kërkesës për shtyrje të afatit për paraqitjen e deklaratës në formën e kërkuar nga ligji nga personat, te të cilët kishte qëndruar jashtë shtetit, në Greqi, për të provuar shpenzimet e akomodimit; (e vetmja kërkesë e re për të cilën Komisioni nuk kishte disponuar në vendimin e datës 03.03.2020). Lidhur me këtë kërkesë, Komisioni konstatoi se subjektit i ishte kërkuar provimi me dokumentacion për këtë shpenzim që më 18.07.2019, ridërguar komunikimi në datën 09.09.2019, në vijim shtyrë afati deri në datën 30.9.2019.

¹⁹ Lidhur me kërkimin e parë mbi revokimin e vendimit të ndërmjetëm të datës 3.3.2020, referuar bazës ligjore, të kërkimit të subjektit, ky kërkim është i pabazuar, për arsye se Komisioni nuk e ka tagrin të disponojë mbi ankimet e subjekteve kundër vendimeve të ndërmjetme, dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, të cilat ankimohen në përputhje me nenin 63 të ligjit nr. 84/2016 në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

a) Në materie të pretendimit të subjektit se Komisioni ka rrëzuar kërkesën për marrjen e provave të tjera, duke i privuar në këtë mënyrë atij një nga të drejtat kryesore, atë të barrës së provës, trupi gjykues i Komisionit njoftoi subjektin se kjo kërkesë e pretendim i tij ishte i pabazuar dhe jo i saktë.

b) Vendimi i ndërmjetëm i trupit gjykues, datë 3.3.2020, nuk ka disponuar mbi rrëzimin e kërkesës për marrjen e provave të tjera, por për refuzimin e kërkesës për shtyrje afati për të paraqitur prova, për arsye se trupi gjykues i ka shtyrë afatin disa herë subjektit për t'i dhënë mundësi për të siguruar provat. Komisioni gjithashtu njoftoi subjektin se nuk i ka privuar të drejtën për të paraqitur prova, e se provat ai mund t'i paraqiste deri në përfundim të seancës dëgjimore.

Lidhur me kërkimin e dytë për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se provat për kriterin e pasurisë kanë arritur nivelin e provueshmërisë, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, kërkesa për riçelje të hetimit edhe për dy kriteret e tjera, nuk duhej pranuar.

²⁰ Pas administrimit të kërkesave, Komisioni njoftoi subjektin se për sa i përket kërkesës së tij për riçelje hetimi, pas seancës dëgjimore dhe para marrjes së vendimit përfundimtar, trupi gjykues do të vlerësonte të gjitha provat dhe shpjegimet e dhëna para dhe gjatë seancës dhe, nëse ato do të vlerësoheshin se janë bindëse dhe të mjaftueshme për

subjektin e rivlerësimit mbi mospranimin e kësaj kërkesë, bazuar në nenin 49/6/a të ligjit nr. 84/2016.

12.2. Në analizë të konstatimeve të mësipërme, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i ka dhënë kohën e mjaftueshme subjektit të rivlerësimit për paraqitjen e provave, akteve apo kërkesave të tij, fillimisht në përgjigje të pyetësorëve, më pas në përgjigje të barrës së provës, të përcjellë me rezultatet e hetimit administrativ dhe, më tej, duke i dhënë mundësinë për të paraqitur prova apo akte deri ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore të zhvilluar në Komision. Trupi gjykues, gjithashtu, gjen të pavërtetë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se rezultatet e hetimit paraprak i janë dërguar në datën 28.02.2020, pasi nga analizimi i akteve të ndodhura në dosjen e Komisionit, konstatohet se ato i janë përcjellë me e-mail-in e datës 20.02.2020, duke i garantuar në këtë mënyrë të drejtën e njohjes me rezultatet e hetimit, të mbrojtjes dhe paraqitjen e provave.

Trupi gjykues i Kolegjit, për sa arsyetuar më sipër, e vlerëson të drejtë vendimin e ndërmjetëm të datës 03.03.2020, të Komisionit, për refuzimin për shtyrje të afatit për paraqitjen e provave në kushtet kur subjektit të rivlerësimit i ishte shtyrë disa herë afati për paraqitjen e tyre. Hetimi administrativ ka zgjatur për një periudhë prej rreth 12 muaj, shkurt 2019 (përgjigjet e pyetësorit standard) e deri në shkurt 2020 (përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ). Gjatë gjithë kësaj periudhe subjekti i rivlerësimit ka pasur komunikim të vazhdueshëm me Komisionin. Në dosje gjenden të administruara përgjigjet e rezultateve të hetimit dhe dokumentet shoqëruese në mbështetje të shpjegimeve dhe sqarimeve të dhëna. Trupi gjykues e gjen të bazuar edhe vendimin e ndërmjetëm të datës 10.03.2020, të Komisionit, për rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e rivlerësimit atë të figurës dhe profesional, në kushtet kur provat për kriterin e pasurisë kishin arritur nivelin e provueshmërisë, në kuptim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Lidhur me kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

- i. Vendimi i ndërmjetëm i datës 10.06.2020, i Komisionit, në të cilën është vendosur për mospranimin e kërkesës së tij, datë 08.06.2020, për përjashtimin e trupit gjykues, është dhënë në shkelje të së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor të garantuar nga nenin 6 i KEDNJ-së dhe neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke e kundërshtuar këtë vendim nëpërmjet ankimit.
- ii. Kërkesa tjetër, ajo e datës 15.06.2020, për përjashtimin e trupit gjykues, përmbante shkaqe ligjore të ndryshme nga ato të parashtruara në kërkesën për përjashtim të datës 08.06.2020, prandaj nuk ishte në kompetencën e këtij trupi gjykues të vlerësonte kërkesën për përjashtim, por ishte kompetencë e një trupi tjetër gjykues.
- iii. Kërkesa e tij për përjashtim të trupit gjykues nuk ishte analizuar, pasi nuk ishte shprehur për kallëzimin penal të paraqitur nga ai të depozituar në Prokurorinë e Posaçme dhe në Prokurorinë e Shkallës së Parë Tiranë, për trupin gjykues. Subjekti i rivlerësimit, duke pasur

rihapjen e hetimit, atëherë Komisioni do të procedonte me marrjen e vendimit për rihapjen e hetimit, për sa i përket kërkesës së tij, për dhënie kohë shtesë për paraqitjen e dokumentacionit për punësimin e djalit L. A., në Greqi.

bindjen e plotë për njëanshmërinë e trupit gjykues, kërkon nga Kolegji prishjen e vendimit të ndërmjetëm të datës 10.06.2020.

13.1. Nga analizimi i akteve të dosjes, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, fillimisht nëpërmjet postës elektronike në datën 06.06.2020 dhe, më pas, në datën 08.06.2020, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., kërkesën për përjashtimin e trupës gjykuese të Komisionit, pasi ka konstatuar se znj. Xh. P. dhe znj. E. Ç. kanë dhënë vendimin nr. {***}, datë 21.06.2018, ndaj subjektit të rivlerësimit I. T., vendim në të cilën janë pasqyruar të dhëna për figurën²¹ e z. Petrit Aliaj si gjyqtar, duke paragjykuar dhe paravendosur në këtë mënyrë procesin e tij të rivlerësimit me shkarkimin e tij nga detyra.
- ii. Me vendimin nr. {***}, datë 08.06.2020, është caktuar trupa gjykuese që do të gjykonte kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit që rivlerëson çështjen e tij. Me vendimin e datës 10.6.2020, pas vlerësimit të shkaqeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit u vendos *mospranimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e trupit gjykues, si të pabazuar në ligj dhe në prova*. Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi këtë vendimarrje me e-mail-in e datës 12.06.2020.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar kërkesë tjetër me nr. {***} prot., datë 15.06.2020, me objekt përjashtimin e trupit gjykues të përbërë nga komisioneret Xh. P., E. Ç. dhe B. B., me argumentin se është në marrëdhënie konfliktuale dhe armiqësore me to, pasi ka bërë kallëzim penal ndaj trupës gjykuese, në Prokurorinë e Posaçme dhe Prokurorinë panë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyre” dhe “Falsifikim i dokumenteve”.
- iv. Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 15.06.2020, se kërkesa për përjashtim e trupit gjykues është e përsëritur dhe se Komisioni ka disponuar me vendimin e datës 10.06.2020, duke e rrëzuar kërkesën si të pabazuar në ligj dhe në prova.

13.2. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dy kërkesa për përjashtim të trupit gjykues, fillimisht më datë 08.06.2020 dhe, më pas, më datë 15.06.2020.

13.2.1. Lidhur me kërkesën për përjashtim të datës 08.06.2020, në të cilën subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se anëtarët e trupit gjykues Xh. P. dhe E. Ç. e kanë paragjykuar subjektin e rivlerësimit, pasi në një vendim tjetër të Komisionit nr. 26, datë 21.06.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit I. T., konkretisht në faqen 10-15 të tij, kanë shprehur apo kanë dhënë mendim duke e cilësuar atë (subjektin e rivlerësimit) si “gjyqtari mitëdhënës”, trupi gjykues nga analizimi i vendimit nr. 26, datë 21.06.2018, të Komisionit, konstaton se në asnjë paragraf të tij nuk citohet emri i subjektit të rivlerësimit.

²¹ Sipas subjektit, nga analizimi i vendimit nr. 26, datë 21.06.2018, rezulton që gjyqtari Petrit Aliaj të jetë përmendur si “gjyqtari mitëdhënës”, por ai nuk është pyetur nga Komisioni gjatë këtij verifikimi lidhur me rrethanat e ngjarjes ku subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni të plotë.

13.2.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor në procedurat e ndjekura nga të tri anëtarët e trupës së tij në Komision, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim të gjithë aktet e prodhuara gjatë zhvillimit të procedurës administrative në Komision dhe arriti në konkluzionin se veprimet e komisionerëve nuk vlerësohen të tilla, që do të përbënin arsye serioze që do të çonin në njëanshmërinë e tyre gjatë vendimmarrjes së tyre në procesin e rivlerësimit të subjektit, referuar kjo dhe nenit 30, shkronja “g” të Kodit të Procedurës Administrative.

13.2.3. Trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se vendimi i datës 10.06.2020, për mospranimin e kërkesës, datë 08.06.2020, për përjashtimin e trupit gjykues, është i drejtë, pasi nuk plotësohen asnjë nga kërkesat e parashikuara të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile²², si dhe shkaqet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në kërkesën e datës 08.06.2020, nuk kanë qenë të tilla që mund të ndikojnë apo të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave të anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit.

13.2.4. Lidhur me kërkesën tjetër për përjashtim të trupit gjykues, protokolluar në Komision nr. {***} prot., datë 15.06.2020, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në kërkesën e datës 15.06.2020, paraqet si argument kryesor të kërkesës për përjashtim të trupës gjykuese, faktin se ka depozituar kallëzimin penal²³ pranë Prokurorisë së Posaçme dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj trupit gjykues që merret me procesin e tij të rivlerësimit znj. Xh. P., znj. E. Ç. dhe znj. B. B., për kryerjen e veprave penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Falsifikimit të dokumenteve” dhe, në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit pretendon se ndodhet në marrëdhënie konfliktuale dhe armiqësore, çka përbën shkak për përjashtimin e tyre, pasi ekziston situata e konfliktit të interesit me këtë trup gjykues.

13.2.5. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kërkesa e datës 15.06.2020, për përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit, është depozituar ditën e shpalljes së vendimit, pra, kur kishte përfunduar seanca dëgjimore, pikërisht, kur trupa gjykuese e Komisionit ishte në fazën e vendimmarrjes për subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, vërehet se argumentet e paraqitura në kallëzimin penal ndaj trupit gjykues nga subjekti i rivlerësimit janë pothuajse të njëjtë me argumentet e paraqitura në kërkesën për përjashtim të trupit gjykues të Komisionit, datë 08.06.2020, si dhe trupa gjykuese që mori në shqyrtim kërkesën e parë të datës 08.06.2020, për përjashtim të znj. Xh. P., znj. E. Ç. dhe

²² 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; 2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit; 3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve; 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërit apo tjetrit palë; 5. është kujdestar, punëdhënës i njërit prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim; 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

²³ Në kallëzimin penal të depozituar me nr. {***}, datë 15.06.2020, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se anëtarët e trupit të tij gjykues në procesin e rivlerësimit në hetimin e raportit kanë arritur në përfundime të rreme në kundërshtim me provat e administruara, pasi ato vijnë në kundërshtim me konkluzionet e vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 04.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

znj. B. B., ka pasur dijeni²⁴ për kallëzimin penal të kryer nga subjekti i rivlerësimit në datë 08.06.2020, (protokolluar disa ditë më vonë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. {***}prot., datën 15.06.2020).

Lidhur me këtë pretendim të subjektit, konstatohet se kërkesa e tij për përjashtimin e trupit gjykues në datën 15.06.2020 është dërguar nëpërmjet komunikimit elektronik dhe ka mbërritur në adresën zyrtare të Komisionit në orën 09:22. Trupi gjykues i Komisionit, nga procesverbali i marrjes së vendimit, rezulton të jetë mbledhur për marrjen e vendimit objekt shqyrtimi në orën 09:00 për të zhvilluar bisedimet të cilat nga po ky akt rezultojnë të kenë përfunduar në orën 09:30. Kolegji konstaton se kërkesa e subjektit të rivlerësimit është paraqitur në një fazë procedurale, kur Komisioni ishte tërhequr për marrjen e vendimit përfundimtar, që do të thotë se çdo komunikim me palët ishte përfunduar dhe Komisioni duhet të vendoste mbi aktet të cilat ishin administruar ndërkohë. Në këto kushte, objektivisht, në respektim të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues e ka pasur të pamundur të marrë dijeni për çdo kërkesë të paraqitur në këtë fazë prej subjektit dhe me të drejtë nuk e ka trajtuar atë. Përgjigja që subjektit i është kthyer nga Komisioni ka natyrë administrative, por nuk rezulton të jetë një vendim i marrë prej trupit gjykues, i cili kishte marrë, ndërkohë, vendimin për zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

13.2.6. Referuar sa më sipër, shumica e trupit gjykues të Kolegjit, duke mbajtur në konsideratë sjelljen e subjektit gjatë gjithë procesit të tij të rivlerësimit, (me paraqitjen e vazhdueshme të kërkesave për shtyrjen e seancave dëgjimore), e konsideron edhe kërkesën e dytë të paraqitur në datën 15.06.2020, për përjashtim të trupit gjykues, pikërisht ditën e shpalljes së vendimit, si një instrument të përdorur nga subjekti, për të penguar procesin e tij të rivlerësimit.

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon se veprimtaria e Komisionit është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike që duhet të kenë subjektet e ligjit për të zhvilluar normalisht veprimtarinë jetësore dhe profesionale pasi:

- i. Vendimi objekt shqyrtimi është mbështetur tërësisht në dokumentacion ose në momente të cilat janë gjykuar me vendim të formës së prerë nga një gjykatë e krijuar me ligj, konkretisht me vendimin nr. {***}, datë 04.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, vendim ky i formës së prerë, i cili ka trajtuar të gjitha pretendimet e ngritura nga ana e Komisionit.
- ii. Hetimi i realizuar nga Komisioni dhe vendimi i tij përbëjnë haptazi një cenim flagrant të parimit të sigurisë juridike parim i trajtuar gjerësisht në praktikën dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (vendimi nr. 3, datë 06.02.2018, vendimi nr. 20, datë 15.04.2014). Rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë më parë subjekt i një hetimi gjyqësor për faktet e ngritura nga Komisioni dhe gëzon pritshmërinë ligjshme të mos gjykohet dy herë për të njëjtat fakte
- iii. Vendimi i Komisionit nuk është rezultat i një procesi të drejtë gjyqësor, pasi qartazi është rezultat i ndërhyrjeve të autoriteteve shtetërore, me qëllim minimizimin e kostove të procesit publik, çka e bën këtë vendimmarrje në kundërshtim me praktikën e GJEDNj-së.

²⁴ Referuar procesverbalit nr. {***}, datë 08.06.2020, mbi dokumentet e dorëzuara nga djali i subjektit të rivlerësimit në Komision, konstatohet se në kërkesën për përjashtim të datës 08.06.2020, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur të njëjtin kallëzimin penal mbi të cilin mbështet pretendimin e tij në kërkesën e dytë për përjashtim, datë 15.06.2020.

14.1. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues mori në shqyrtim aktet e ndodhura në dosjen e ILDKPKI-së dhe fashikujt e përcjellë nga Komisioni nga ku konstaton se:

- i. ILDKPKI-ja, pasi përfundoi kontrollin e plotë të deklaratave të interesave private të subjektit Petrit Aliaj, si dhe analizoi të gjithë dokumentacionin e administruar, korrespondencën me institucionet publike dhe bankare, ka konstatuar se subjekti Petrit Aliaj ka kryer deklaram të rremë, fshehje pasurie dhe mosdeklarim të burimeve financiare. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së ka paraqitur para Prokurorit të Përgjithshëm kallëzim penal²⁵ ndaj subjektit Petrit Aliaj.
- ii. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, më datë 18.01.2016, në mbështetje të nenit 328, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale, vendosi të pushojë çështjen penale nr. {***}, viti 2015, duke vlerësuar se: “[...] me gjithë hetimet e kryera nuk u bë e mundur të provohet se faktet objekt hetimi përbëjnë veprë penale [...]”.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka ankimuar vendimin e pushimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan me pretendimin se prokuroria duhej të kishte konkluduar me përcaktimin se “fakti nuk ekziston”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 04.07.2016, ka vendosur rrëzimin e ankimit²⁶ të ankuesit Petrit Aliaj, duke lënë në fuqi vendimin e pushimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

14.2. Komisioni ka vlerësuar se procesi i natyrës administrativo-disiplinore, i rivlerësimit të pasurisë së subjektit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nuk përjashtohet dhe nuk paragjykohet nga vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 04.07.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në paralelizëm kjo dhe me nenin 126, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”²⁷. Miratimi i paketës ligjore të reformës në drejtësi në vitin 2016 dhe ligjet e miratuara²⁸ në funksion të procesit të *vetting*-ut kanë parashikuar një rregullim specifik mbi mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Procesi i *vetting*-ut nuk ka synim konstatimin e përgjegjësisë penale, por ka për qëllim të evidentojë gjyqtarët dhe prokurorët që kanë në pronësi pasuri që nuk mund t’i justifikojnë ligjërisht ose që nuk kanë deklaruar

²⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.06.2015, Inspektori i përgjithshëm i ILDKPKI-së ka kërkuar fillimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga nenet 257/a/2, 186 dhe 287 të Kodit Penal, ndaj gjyqtarit Petrit Aliaj.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, të vitit 2015, për veprat penale “Refuzimit për deklaram, mosdeklarim, fshehje ose deklaram i rremë i pasurisë, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklaram” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal.

²⁶ Mee argumentimin se: “[...] nuk ndodhemi para mosekzistencës së faktit, pasi deklaramet e interesave private të subjektit, për shkak të mospërputhjes të asaj çfarë është deklaram me konstatimet e kryera nga kallëzuesi, kanë çuar në domosdoshmërinë e një hetimi dhe vetëm në përfundim të këtij hetimi prokurori ka arritur të konkludojë se kemi mungesë të elementeve të veprës penale objekt hetimi [...]”.

²⁷ Vendimi i formës së prerë i gjykatës në favor të magjistratit nuk pengon hetimin nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të magjistratit.

²⁸ Neni 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përcakton: “Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit Në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ mund të kërkojnë informacion në institucionet përkatëse.

saktësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur me ta, të cilat çojnë në dyshimin e krijimit të tyre nga veprime korruptive, abuzime me detyrën dhe veprimtari të kundërligjshme.

14.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka trajtuar në vendimmarrjen e tij fakte dhe rrethana që janë trajtuar më parë, me vendimin nr. {***}, datë 04.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, trupi gjykues i Kolegjit çmon se objekt i hetimit penal nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka qenë nëse faktet dhe të dhënat e paraqitura në kallëzimin e ILDKPKI-së kanë elementë të veprës penale. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk ka marrë në shqyrtim themelin e çështjes, por ka kontrolluar zbatimin e rasteve të parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale nga ana e Prokurorisë, referuar kjo dhe Vendimit nr. 2/2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatë së Lartë²⁹ mbi detyrat e gjykatës në gjykimin e çështjeve me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes. Vendimi nr. {***}, datë 04.07.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka analizuar vetëm kërkesën e ankuesit mbi ekzistencën e faktit objekt hetimi penal dhe nuk mund të konsiderohet si gjykim, në kuptim të nenit 7 të Kodit të Procedurës Penale.

Trupi gjykues çmon të theksojë se deklarata e procesit të rivlerësimit *vetting* e plotësuar dhe dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, në zbatim të nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur saj, si një nga dokumentet kryesor që mbështeten organet e rivlerësimit në vlerësimin e pasurisë së subjektit, nuk ka qenë objekt hetimi nga Prokuroria Rrethit Gjyqësor Elbasan.

14.4. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas së cilit Komisioni dhe Kolegji hetojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes dhe kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli e vlerësimi, pa u bazuar dhe pa qenë të detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet ndihmëse, përfshirë edhe ILDKPKI-në. Komisioni ka tagrin që, pavarësisht rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit.

14.5. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pavarësisht hetimit dhe konkluzioneve të ILDKPKI-së, se subjekti Petrit Aliaj ka kryer deklaram të rremë, fshehje pasurie dhe mosdeklaram të burimeve financiare, si dhe ka përcjellë dhe kallëzimin penal, datë 08.06.2015, procesi i *vetting*-ut i parashikuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në ligjin³⁰ nr. 84/2016 është nën kompetencën ekskluzive të organeve të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit, duke pasur të drejtën dhe detyrimin të hetojnë dhe kontrollojnë në mënyrë të pavarur

²⁹ Paragrafi 40. “Në gjykimin me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes, funksioni i gjykatës është kontrolli lidhur me zbatimin e drejtë dhe korrekt të rasteve të parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, edhe sipas nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata merr vendim duke disponuar, sipas rastit, shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes ose rrëzimin e kërkesës së ankuesit kur ai është i dëmtuari, ndërsa kur ankues është i pandehuri, gjykata mund t’i japë një formulim të ndryshëm vendimit të pushimit më të favorshëm për të pandehurin”.

³⁰ Neni 4, pika 2 e ligjit nr. 86/2016 parashikon: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

pasurinë, figurën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit, për sa më sipër konsiderohet i pabazuar ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit.

15. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit nuk është rezultat i një procesi të drejtë gjyqësor, pasi qartazi është rezultat i ndërhyrjeve të autoriteteve shtetërore, trupi gjykues konstaton se subjekti e ka ngritur këtë pretendim, pa paraqitur ndonjë fakt apo rrethanë konkrete, pasi nuk ka shpjeguar se në cilat momente procedurale ka konstatuar këto ndërhyrje të autoriteteve shtetërore, për rrjedhojë, ky pretendim i tij mbetet vetëm në nivel deklarativ dhe i pambështetur në prova.

16. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton si të gabuar konkluzionin e Komisionit se ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, pasi ai është shprehur i gatshëm për të vënë në dispozicion të Komisionit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, përveç rasteve kur nuk ka qenë e mundur për arsye objektive. Komisioni ka cenuar procesin e rregullt ligjor dhe pamundësia e tij objektive për t'u paraqitur në seancën dëgjimore është e mbështetur në prova shkresore.

16.1. Lidhur me këtë shkak ankimi, sikurse konstatohet nga analiza e fakteve të pasqyruara më lart, konkretisht kërkesat e shpeshta të subjektit të rivlerësimit për vënie kohe në dispozicion, duke paraqitur disa herë kërkesa për shtyrjen e afatit për paraqitjen e provave, paraqitur dy herë kërkesa për përjashtimin e trupit gjykues, si dhe paraqitja e raporteve mjekësore, pikërisht në ditën kur ishte caktuar seanca dëgjimore në Komision, duke u përpjekur të shtyjë seancën dëgjimore, tregojnë qartë për përpjekjet e tij për shtyrjen dhe vonesën e procesit e tij të rivlerësimit.

16.2. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit me sjelljet e tij, gjatë gjithë procedurës së rivlerësimit, nuk është treguar bashkëpunues, duke vepruar në kundërshtim me parashikimin e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij është përpjekur të ndikojë në pengimin e punës së organeve të rivlerësimit, proces ky që ka si qëllim rritjen e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, duke përmbushur në këtë mënyrë kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17. Kolegji arriti në përfundimin se në referencë të parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, debati gjyqësor nuk ishte i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendim nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

C. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e pasurisë

18. Lidhur me pasurinë banesë private e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë me sipërfaqe ndërtimi 105 m² e ndërtuar mbi tokën me sipërfaqe 200 m², ndodhur në lagjen nr. {***}, Sarandë

18.1. Komisioni, pasi ka konstatuar se deklarimet³¹ e subjektit të rivlerësimit nuk përputhen, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, ka vlerësuar³² se kostoja e ndërtimit të banesës në vitin 2004

³¹ Në deklarinë para ILDKPKI-së në datën 01.11.2004 ka deklaruar si burim për ndërtimin e kësaj banese, një pjesë të ardhurat e përfutuara nga shitja e banesës në Delvinë dhe pjesa tjetër huaja e marrë, kurse në deklaratën e pasurisë vetting subjekti ka deklaruar se ka shërbyer si burim huaja e marrë shtetasit P. K. me vlerë 25.000.000 (njëzet e pesë milion) dhrahmi në vitin 2000.

³² Paragrafët 47.5, 47.7, 47.8 dhe 47.9, faqe 12, të vendimit të Komisionit.

nuk u arrit të provohet nga subjekti i rivlerësimit se është mbuluar me të ardhura të ligjshme, për sa nuk është provuar se huaja e marrë në vitin 2000 është përdorur për këtë investim. Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të ndërtimit të kësaj pasurie në vitin 2004, në kuptim të shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

18.2. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, ka paraqitur këto pretendime:

18.2.1. Në procesverbalin e deklarimeve, datë 01.11.2004, të mbajtur në ILDKPKI, ka sqaruar se banesa është ndërtuar pa fuqi punëtore, me kontributin e subjektit të rivlerësimit, të vëllait dhe motrës, pasi ata janë teknik ndërtimi. Në lejen e ndërtimit nr. {***}, datë 10.09.2003, dhënë nga KRRTja Bashkia Sarandë janë pasqyruar pjesët takuese 1/3, në mënyrë të barabartë, në favor të shtetasve Petrit Aliaj, Xh. A. dhe M. A..

18.2.2. Në momentin e paraqitjes së kërkesës për bashkim pasurie truall + ndërtesë, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në ZVRPP-në Sarandë prokurën e përfaqësimit të vëllait dhe motrës, nuk është përgjegjësi e tij se në dosjen e zyrës së ASHK-së Sarandë nuk ndodhet ky akt përfaqësimi.

18.2.3. Vlera e investimit të objektit të kësaj banese është përcaktuar nga ekspertja e caktuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku nga akti i ekspertimit teknik është konkluduar se vlera sipas kostos së ndërtimit të vitit 2004 është në shumën 10.150.116 lekë.

18.2.4. Në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim të vitit 2003 ka deklaruar kontratën e huamarrjes të lidhur me huamarrësin P. K. në shumën 25 milion drahmi, për pasojë është deduksion logjik që është përfituar dhe shuma *cash* nga huamarrja. Në të njëjtën deklaratë të vitit 2003, në rubrikën e arsyeve të krijimit të detyrimit të huamarrjes ka deklaruar “*për të bërë ndërtim shtëpi private*”, është detyrim i Komisionit të konkludojë se huaja e marrë në vitin 2000 nga shtetasi P. K. është përdorur për ndërtimin e shtëpisë së banimit.

18.2.5. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë koston e fuqisë punëtore, e cila është në masën 17% të vlerës së përgjithshme të kostos së ndërtimit, në shumën 1.725.000 lekë dhe kjo kosto duhej llogaritur me të ardhura të ligjshme, pasi ashtu siç ka deklaruar në deklaratën e pasurisë “*vetting*” kjo banesë është ndërtuar nga vëllai Xh. A. dhe burri i motrës S. K..

18.3. Trupi gjykues i Kolegjit, fillimisht mori në analizë pretendimin e subjektit për llogaritjen e kostos së ndërtimit të objektit banesë private e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues, lidhur me vlerën e investimit të kryer për ndërtimin e objektit banesë private e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë me sipërfaqe ndërtimi 105 m², si dhe në mungesë të deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të vlerës së shpenzuar/investuar në krijimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit për mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndërtimit mbi bazë analize të kostos së objektit, sipas çmimit për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit, bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 04.03.2004, “*Për miratimin e kostove mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe koeficientit K*”, ku kosto

e ndërtimit për vitin 2004³³ në qytetin e Sarandës ka qenë në vlerën 24.935 lekë/m², përlllogaritur me sipërfaqen e objektit 420 m², vlera e ndërtimit rezulton 10.472.700 lekë.

18.4. Lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të saj, trupit gjykues, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë “*vetting*”³⁴, deklaratat e interesave periodike private dhe pasi verifikoi dokumentacionin e administruar nga Komisioni, i rezultoi se:

18.4.1. Në deklaratën e interesave private të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *se kam aplikuar më datë 10.02.2005, në ZVRPP-në Sarandë mbi një objekt në bashkëpronësi në Sarandë me Xh. A. dhe M. K.* Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie duke mos përcaktuar as sipërfaqen dhe as vlerën e ndërtimit.

18.4.2. Me vendimin nr. {***}, datë 10.09.2003, të KRRT-së Bashkia Sarandë është miratuar leja e ndërtimit për banesë private në lagjen nr. {***}, Sarandë, me bashkëinvestitor shtetasit Petrit Aliaj, Xh. A. dhe M. A. (K.). Me aktin e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2012, pala dhuruese Xh. A. (i vëllai) dhe M. K. (A.) (e motra) i kanë dhuruar subjektit të rivlerësimit Petrit Aliaj objektin banesë e përbërë nga kati nën tokë dhe tri kate mbi tokë, me sipërfaqe ndërtimi prej 105 (njëqind e pesë) m² për çdo kat, në total 420 m² e ndodhur në lagjen nr. {***}, Sarandë, kontratë kjo e deklaruar në deklaratën e interesave periodike të vitit 2012 nga subjekti i rivlerësimit.

18.4.3. Me kontratën e huamarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.7.2000, huadhënësi P. K. i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 25.000.000 drahmi greke, shumë e cila sipas kësaj kontrate është dorëzuar jashtë zyrës noteriale. Shlyerja e kësaj shume do të kryhej brenda një afati 6-vjeçar në përfundim të çdo viti, ku huamarrësi do t’i kthente huadhënësit interesat mujore prej 5 % në çdo muaj.

18.4.4. Në deklaratën noteriale³⁵ nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2016, z. P. K. ka konfirmuar dhënien e kësaj shume (25.000.000 drahmi greke) dhe kthimin e saj nga shtetasi Petrit Aliaj ndarë në tri këste.

³³ Analiza financiare është kryer për vitin 2004, duke konsideruar se ndërtimi është përfunduar në vitin 2004, bazuar në deklaratën e interesave periodik të vitit 2004 dhe deklaramit të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit se kosto e ndërtimit e financuar nga subjekti i rivlerësimit, ka qenë në masën 83 % të koston totale. Në ndryshim nga sa pretendon subjekti, referuar koston së ndërtimit të banesës, nga analiza e Komisionit për vitin 2004, vihet re se Komisioni e ka zbritur nga vlera e banesës vlerën 17% të fuqisë punëtore, sipas deklaramit të subjektit në deklaratën e pasurisë, por kostoja e ndërtimit të banesës së llogaritur nga Komisioni mbetet në vlerën 10.472.700 lekë.

³⁴ Në deklaratën e pasurisë “*vetting*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Banesë private e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë, e sipërfaqe ndërtimi prej 105 m², e ndërtuar mbi tokën me sipërfaqe 200 m², në Sarandë, nga ku 2/3 banesë në pronësi të Petrit Aliaj, 1/3 banesë pasuri bashkëshortore Petrit Aliaj dhe K. A., ku vlera e saj, sipas koston së ndërtimit të vitit 2004, është 10.150.116 (dhjetë milion e njëqind e pesëdhjetëmijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë. Për ndërtimin e kësaj banese private të ndërtuar nga vetë bashkëpronarët Petrit Aliaj, Xh. A, M. K. (A.) me kontratën e huamarrjes nr. 230 rep., nr. 230 kol., datë 22.07.2000, unë shtetasi Petrit Aliaj kam marrë nga shtetasi P. K. shumën prej 25.000.000 (njëzet e pesë milion) drahmi greke të barazvlefshme me 10.000.000 (dhjetë milion) lekë, ku ky shtetas e ka të siguruar këtë shumë nga aktiviteti i tij i biznesit në shtetin grek nga deklarata noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 26.11.2016, rezulton se shuma e huas e sipërpërmendur i është shlyer tërësisht shtetasit P. K.*”

³⁵ Në këtë deklaratë citohet: “*Unë shtetasi P. K. deklaroj me vullnetin dhe përgjegjësinë time ligjore të plotë se shtetasi Petrit M. A. ka marrë prej meje një shumë huaje prej 25.000.000 (njëzet e pesë milion) drahmi me kontratën e huas*

18.4.5. Në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti ka deklaruar se ka shlyer detyrimin në shumën 60.000 USD shtetasit P. K., por papërcaktuar burimin e shlyerjes së këtij detyrimi.

18.4.6. Sipas deklaramit të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, huaja e marrë shtetasit P. K., në shumën 25.000.000 dhrahmi greke, është shlyer në tri këste, si më poshtë:

- Për kryerjen e pagesës së këstit të parë, në shumën prej 60.000 dollarë amerikanë në vitin 2006, si burim kanë shërbyer: shuma prej 47.000 dollarë amerikanë, e përfituar nga ushtrimi i profesionit të Avokatit; shuma prej 1.019.565 lekësh përfituar nga zbatimi i vendimit nr. 12, datë 08.03.2006, të Gjykatës së Lartë; si dhe shuma prej 280.435 lekësh, e ardhur nga gjendja *cash*, pas mbylljes së depozitës bankare në emër të bashkëshortes K. A., në Bankën e Kursimeve.
- Për kryerjen e pagesës së këstit të dytë, në shumën prej 15.000 dollarë amerikanë në vitin 2007, si burim ka shërbyer, shuma e dhënë nga vëllai e siguruar nga puna në emigracion.
- Për kryerjen e pagesës së këstit të tretë, të shumës prej 25.000 dollarë amerikanë në vitin 2008, si burim ka shërbyer shuma e dhënë hua pa interes nga babai M. A..

18.5. Trupi gjykues i Kolegjit, me qëllim verifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, mori në shqyrtim dokumentacionin lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e huas së marrë shtetasit P. K., si dhe analizoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për shlyerjen e huas, ndër vite, nga ku rezulton.

18.5.1. Komisioni³⁶ ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë përdorimin e shumës 48.000 USD nga shërbimi i konsulencës, si burim për shlyerjen e huas në vitin 2006, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

18.5.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konfirmimi i ushtrimit të aktivitetit të profesionit të avokatisë gjatë vitit 2005, provohet nga shkresa e datës 01.06.2015, e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkisë Sarandë, ndërsa përfitimi i shumës prej 48.000 dollarë amerikanë konfirmohet me vërtetimet e lëshuara nga shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, si dhe ka paraqitur aktet³⁷ përkatëse në mbështetje të pretendimeve të tij. Subjekti i rivlerësimit e konsideron lapsus, deklaramin e periudhës së ushtrimit të profesionit të avokatit, në deklaratën periodike të vitit 2006.

*nr. {***} kol., datë 22.07.2000. Kjo shumë është kthyer prej shtetasit Petrit Aliaj në tri këste. Kësti i parë është shlyer në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) dollarë, kësti i dytë është shlyer nga shtetasi Xh. A i cili është i vëllai i Petrit Aliaj në shumën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) dollarë, si dhe kësti i tretë është shlyer nga Petrit Aliaj në shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) dollarë”.*

³⁶ Paragrafi 50.5, faqe 14, i vendimit të Komisionit.

³⁷ (a) vërtetimin, datë 14.02.2008, të shoqërisë SH.R.S.F. “{***}” dhe vërtetimin, datë 10.02.2008, të shoqërisë “{***}”, me anë të të cilave kërkohet të provojë përfitimin e shumës prej 48 mijë dollarë në vitin 2005, duke punuar si konsulent pranë këtyre shoqërive; (b) vërtetim, datë 01.06.2013, të firmosur nga Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Sarandë T. M., me anë të të cilës vërtetohet se z. Petrit Aliaj ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2005, pranë Bashkisë Sarandë si biznes i vogël për aktivitetin “Avokati” që ka ushtruar në qytetin e Sarandës. (c) shkresë nr. {***} prot., datë 31.7.2017, të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Sarandë³⁷ dhe mandatin bankar, sipas të cilës kërkohet të provojë kryerjen e pagesës së detyrimeve tatimore për vitin 2005, në vitin 2009, pra, pas 4 vitesh; (ç) leje nr. {***}, datë 15.12.1999, “Për ushtrimin e profesionit të avokatit”, nga Këshilli Drejtues i Dhomës së Avokatëve.

18.5.3. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e Komisionit, me qëllim identifikimin e plotë të rrethanave në raport me situatën ekzistuese dhe atë të pretenduar nga subjekti. Konkretisht, shkresa nr. {***} prot., datë 31.7.2017, e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Sarandë, ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, konfirmon se subjekti ka kryer një pagesë në vitin 2009 me emërtimin “*taksë biznesi i vogël për ushtrimin e aktivitetit Avokat për vitin 2005*”, duke iu referuar një mandati të disa viteve më vonë (viti 2009), të njëjtin fakt pasqyron edhe vërtetimi, datë 01.06.2015, i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkisë Sarandë. Shkresa nr. {***} prot., datë 01.08.2019³⁸, me lëndë “*Kthim përgjigje*”, e firmosur nga Kryetarja e Bashkisë Sarandë, drejtuar Komisionit, konfirmon faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur biznes të regjistruar pranë Bashkisë Sarandë, si dhe shkresa nr. {***} prot., datë 01.08.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë³⁹, konfirmon faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore.

18.5.4. Në vijim të kësaj analize, trupi gjykues i Kolegjit, referuar nenit 3 të ligjit nr. 9109, datë 17.07.2003, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, vëren se ky profesion ushtrohet, pasi individët aplikojnë dhe regjistroheshin në organet tatimore përkatëse, duke deklaruar aktivitetin që ushtronin. Gjithashtu, legjislacioni tatimor nuk ka pasur parashikime ligjore për kategori personash që mund të ushtronin veprimtari ekonomike, pa u regjistruar më parë në administratën tatimore, pra, profesioni i avokatit ka pasur të gjitha detyrimet për regjistrim si gjithë personat e tjerë. Referuar udhëzimit nr. 2, datë 10.04.2003, “Për procedurat tatimore”, të Ministrisë së Financave, konkretisht pikës 2 të tij “Procedura e administrimit të tatimeve”, 2.1 “Regjistrimi i tatimpaguesve”⁴⁰, dokumentacioni që kërkohej të paraqitnin subjektet tregtare, për regjistrimin pranë organeve tatimore, ishte vendimi i regjistrimit në Gjykatë, kontratë me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, si dhe pasi të regjistroheshin në organin tatimor duhej të pajiseshin me certifikatën përkatëse të ushtrimit të veprimtarisë.

18.5.5. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument nga ato të parashikuar nga udhëzimi i sipërcituar me qëllim provimin e ushtrimit të këtij aktiviteti në përputhje me legjislacionin e kohës. Ndërsa, lidhur me mospërputhjen e vitit të ushtrimit të

³⁸ “Shtetasi Petrit M. Aliaj. nuk ka pasur biznes të regjistruar pranë Bashkisë Sarandë, për rrjedhojë nuk disponojmë dokumentacionin e kërkuar pranë jush”.

³⁹ “[...] bazuar në të dhënat e Regjistrimit Elektronik të Tatimpaguesve që disponon Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë rezultojnë se deri më datë 01.08.2019, shtetasi Petrit Aliaj nuk është i regjistruar si tatimpagues për qëllime tatimore në Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë [...]”.

⁴⁰ Personat juridikë e fizikë me qarkullim vjetor më të vogël se kufiri i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar tatimpaguesit e taksës vendore mbi biznesin e vogël, përveç vendimit të gjykatës, paraqesin edhe kërkesën për regjistrim, duke plotësuar formularin përkatës. Këto persona paraqesin, gjithashtu, edhe kontratën me Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Ato duhet të plotësojnë, gjithashtu, edhe çdo kërkesë tjetër të përcaktuar në ligjin nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për Taksën Vendore mbi Biznesin e Vogël” dhe në ligje të tjera, si pajisja paraprakisht me licencën profesionale. Personat fizikë e juridikë me qarkullim vjetor më të vogël se kufiri i regjistrimit për TVSH-në, të cilët plotësojnë të gjitha kërkesat e mësipërme, regjistrohen dhe pajisen nga organi tatimor i rrethit me certifikatën përkatëse të ushtrimit të veprimtarisë, brenda pesë ditësh nga momenti i paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe formularit përkatës nga ana e tyre. Regjistrimi dhe certifikata e ushtrimit të veprimtarisë jepet çdo vit, brenda afatit dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për Taksën Vendore mbi Biznesin e Vogël”.

profesionit të avokatit, me deklarin e pasurisë “vetting”⁴¹, në deklaratën periodike të vitit 2006⁴², trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, kishte detyrimin për deklarimin e saktë dhe të plotë, të pasurive, burimet e krijimit të tyre, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet.

18.5.6. Gjithashtu, udhëzimi nr. {***} prot., datë 10.10.2016, i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, në pikën 22, udhëzon që deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga aktiviteti privat i subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur me të, duhet të shoqërohet për periudhën e deklaruar me dokumentacionin justifikues ligjor nga zyrat e tatim taksave për fitimin e realizuar dhe dividendin e tërhequr. Në kushtet kur nuk provohet regjistrimi i subjektit të rivlerësimit në organet tatimore për ushtrimin e profesionit të avokatit, si dhe kryerja e pagesës subjektit nga shoqëria “{***}” ShPK, nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor (mandatpagesë, mandat bankar apo ndonjë dokument tjetër⁴³), trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e pretenduara të përfituara nga ushtrimi i profesionit të konsulentit/avokatit nuk mund të konsiderohen të ligjshme, në kuptim nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka përdorur shumën 47.000 USD të përfituar nga shërbimi i konsulencës për shlyerjen e huas shtetasit P. K. është i pabazuar, pasi ai nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të kësaj shume dhe përdorimin e saj më pas, si burim për shlyerjen e huas në vitin 2006, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

18.5.7. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar analizën e Komisionit, duke mos marrë në konsideratë shumën prej 280.435 lekësh, me burim nga mbyllja e depozitës bankare në emër të bashkëshortes së tij në Bankën e Kursimeve, pasi e konfirmon këtë depozitë me vërtetimin e “Raiffeisen Bank” ShA⁴⁴. Nga analizimi i deklaratave të interesa private periodike, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar shumën prej 280.435 lekësh në deklaratën e interesave periodike të vitit 2003, 2004 dhe 2005, si gjendje *cash*, për rrjedhojë, kjo shumë e padeklaruar, nuk mund të vlerësohet si e ardhur nga një burim i ligjshëm dhe të ketë shërbyer si burim për shlyerjen e huas disa vite më vonë, në vitin 2006, duke u kualifikuar kjo situatë faktike, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

18.6. Lidhur me shumën prej 15.000 USD të dhënë nga vëllai Xh. A., shumë e cila ka shërbyer për shlyerjen e këstit të dytë të huas shtetasit P. K., subjekti i rivlerësimit pretendon se arsyetimi i Komisionit se nuk provohet me dokumentacion ligjor, ligjshmëria e të ardhurave të vëllait të tij dhe pagimi i detyrimeve tatimore është i pabazuar, pasi subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në

⁴¹ Në deklaratën e pasurisë “vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “[...] nga data 03.01.2005 deri më 04.03.2006 kam ushtruar profesionin e konsulentit juridik-avokat pranë firmës SH.R.F.S. ‘{***}’ Delvinë dhe ‘{***}’ Delvinë e kam përfituar për shërbimin juridik shpërblimin prej 48 000 (dyzet e tetë mijë) USA dollarë [...]”.

⁴² Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Nga data 01.03.2005 deri më datë 04.03.2005 kam punuar duke ushtruar profesionin e avokatit dhe kam përfituar shumën e të ardhurave për të gjithë periudhën 47 mijë dollarë amerikan [...]”.

⁴³ Neni 10 i ligjit nr. 9109, datë 17.07.2003, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “Avokatët, në përputhje me dokumentacionin standard, të miratuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, duhet të mbajnë një libër shënimesh ku shënohen të gjitha shërbimet ligjore të dhëna, kontratat, me shkrim, duke përdorur sistemin numerik, emrin e tij, si dhe emrin e zyrës së avokatisë”.

⁴⁴ Vërtetimi nr. {***}, datë 09.08.2017, të “Raiffeisen Bank”, ku vërtetohet se K. A. (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit) ka pasur depozitë në shumën 1.015.741 lekë, e cila është mbyllur në datën 23.04.2004.

cilësinë e provës deklaratën e shtetasit grek N. S., i cili ka konfirmuar marrëdhëniet e punës së vëllait të tij në shtetin grek.

18.6.1. Në funksion të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues i Kolegjit fillimisht mori në analizë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë “*vetting*”, në të cilën ai ka deklaruar se: “*Në vitin 2007 i kam shlyer shtetasit P. K. shumën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë) mijë USD, e cila më është dhënë nga vëllai im Xh. A. për pjesën e tij në bashkëpronësi, 1/3 bashkëpronar në banesë, i cili e ka të siguar këtë shumë nga punësimi në emigracion. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.07.2015, e Xh. A. dhe M. A.*”. Në deklaratën e interesave periodike për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Diferenca e huas ndaj shtetasit P. K. 40 mijë dollarë amerikan, shuma prej 15 mijë dollarë amerikan shlyer nga paga e marrë prej 15 muajsh që kam fituar gjyqin në Gjykatën e Lartë, si dhe nga kursimet familjare*”.

Sikurse rezulton nga deklaratimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007 shumën prej 15.000 dollarësh të marrë nga vëllai i tij Xh. A., e cila sipas deklaratimit të tij në deklaratën e pasurisë “*vetting*” ka shërbyer si burim për shlyerjen e huas shtetasit P. K.. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.07.2015, vëllai i subjektit të rivlerësimit Xh. A. konfirmon faktin e dhënies së shumës prej 15.000 dollarësh vëllait të tij Petrit Aliaj, por papërcaktuar kohën se kur është dhënë kjo shumë.

18.6.2. Lidhur me provueshmërinë e të ardhurave të ligjshme të vëllait të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se i vetmi dokument i paraqitur nga subjekti është deklarata⁴⁵ e shtetasit grek N. S., e cila ka konfirmuar marrëdhënien e punës së personit tjetër të lidhur Xh. A., por nuk përbën dokumentacion justifikues për provueshmërinë e ligjshmërisë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 21 të Udhëzimit, nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së. Këto akte ligjore dhe nënligjore kërkojnë nga subjektet e rivlerësimit dhe nga institucionet e rivlerësimit që për të ardhurat e deklaruara, subjektet e rivlerësimit, persona të lidhur ose persona të tjerë të lidhur me ta, kur këta të fundit janë në kushtet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të provojnë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to. Përveç sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se që ato të konsiderohen të ligjshme, duhet provuar edhe mënyra se si ato kanë mbërritur te subjekti i rivlerësimit.

18.6.3. Të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për punësimin e personit të lidhur, vëllait Xh. A., në Greqi, nuk plotësojnë kushtet për t’u konsideruar si të ligjshme. Për rrjedhojë, bazuar në deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, duke mos e deklaruar shumën prej 15 mijë dollarësh të marrë nga vëllai i tij Xh. A. në deklaratën periodike të vitit 2007, si dhe duke mos arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait të tij, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se shuma prej 15.000 dollarësh nuk mund të ketë shërbyer për shlyerjen e këstit të dytë të huas ndaj shtetasit P. K., në vitin 2007.

18.7. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shuma prej 25.000 dollarë amerikanë, që ka shërbyer për shlyerjen e këstit të tretë të huas shtetasit P. K., i është dhënë hua pa interes nga babai i tij M. A., i cili e ka të siguar këtë shumë nga vëllai i tij S. A., Komisioni⁴⁶ ka vlerësuar se për sa nuk provohet me dokumentacion ligjor mundësia financiare e huadhënësit, z. M. A., për

⁴⁵ Deklaratë me përgjegjësi, datë 02.10.2019, e shtetasit N. S. (pa vulë apostile).

⁴⁶ Paragrafi 55.4, faqe 17, i vendimit të Komisionit.

shumën e dhënë subjektit në vlerën 25.000 USD, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mosjustifikimit të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave, të marra hua në vitin 2008.

18.7.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se babai i tij nuk disponon dokumentacion për shumat e dhëna nga vëllai i tij, pasi gjatë viteve 1992-1995, S. A. (xhaxhai i subjektit të rivlerësimit), i cili është arratisur në vitin 1944 në ShBA dhe më pas në Australi, ka ardhur disa herë në Shqipëri duke i dhënë shuma të mëdha dorazi në dollarë babait M. A., si shpërblim për vuajtjet që ky i fundit kishte kaluar gjatë regjimit komunist, pasi ka qenë i dënuar politikisht.

Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet të merrte në konsideratë faktin se të ardhurat e xhaxhait të tij S. A. janë siguruar në periudha të hershme para vitit 1990 në ShBA, janë transportuar këtu në Shqipëri në vitet 1992-1995, si dhe vdekja e xhaxhait në vitin 2009, janë rrethana që sipas tij e pengojnë subjektin e rivlerësimit për të gjetur dokumentacion justifikues prej institucioneve jashtë vendit, prandaj Komisioni duhej të zbatonte nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

18.7.2. Trupi gjykues, pasi vlerësoi deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë “*vetting*”⁴⁷ dhe në deklaratën⁴⁸ e interesave periodike për vitin 2008, si dhe mori në analizë deklaratën noteriale nr. {***}, datë 05.07.2015⁴⁹, të z. M. A. (babait të subjektit), vërtetimin, datë 01.11.2016, të kryeplakut të fshatit {***}⁵⁰, çmon se këto akte jo vetëm që nuk vërtetojnë marrjen e shumës të babait të subjektit të rivlerësimit M. A. nga vëllai i tij S. A., sipas parashikimit të nenit 32, pikat 1 dhe 4 e ligjit nr. 84/2016, por as nuk vërtetojnë burimin e ligjshëm të këtyre shumave të pretenduar të përfituara në formën e dhuratës, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

18.7.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi pamundësinë objektive për të paraqitur provë shkresore nga xhaxhai i tij S. A., për të provuar të ardhurat dhe burimin e tyre për shkak të vdekjes së tij në vitin 2009, trupi gjykues çmon se nga provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë bërë përpjekje për dokumentimin dhe vërtetimin e burimeve të ligjshme të të ardhurave të pretenduara pranë institucioneve përkatëse të vendit nga janë përfituar këto të ardhura nga xhaxhai i tij S. A.. Gjithashtu, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë që të vërtetonte se dokumenti që justifikonte ligjshmërinë e të ardhurave është zhdukur, ka humbur apo nuk mund të bëhet përsëri.

18.7.4. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e të ardhurave të xhaxhait me

⁴⁷ “Në vitin 2008 i kam shlyer shtetasit P. K. shumën prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) USD, shumë e cila më është dhënë pa interes nga babai im M. A., i cili e ka të siguruar këtë shumë nga vëllai i tij S. A. [...]. Babai im M. A. nuk disponon akt dhurimi për shumat e dollarëve të dhëna si dhuratë nga vëllai i tij S. A., pasi janë dhënë dorazi [...]”.

⁴⁸ “Diferencën e huas ndaj shtetasit P. K. prej 25 mijë dollarë e kam shlyer tërësisht, me ka dhënë M. Z. Aliaj baba im shumën prej 25 mijë dollarë amerikan, i cili e ka të dhuruar nga vëllai i tij S. A. që jeton në Australi që nga viti 1947”.

⁴⁹ “[...] shuma prej 25.000 USD i është dhënë prej meje djalit tim Petrit Aliaj për shlyerjen e huas shtetasit P. K.. Saktësoj faktin se kam pasur dy vëllezër të arratisur që prej vitit 1944 dhe në vitet 1992 – 1995 vëllai im i quajtur S. A. ka ardhur disa herë nga Greqia dhe nga Tirana dhe fillimisht më ka sjellë një shumë të madhe lekësh në monedhë dollarë, ku një pjesë të kësaj vlere prej 150.000 USD ia kam bërë të ditur djalit tim Petrit Aliaj [...]”.

⁵⁰ Me anë të së cilës unë kryeplaku i fshatit M. S. M. vërtetoj se nga informacioni që kam nga bashkëfshatarët dhe prindërit e mi, shtetasi (I ndjeri) S. A. është arratisur nga vendi në vitin 1944 dhe ka jetuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Australi. Me ardhjen e demokracisë i ndjeri S. A. ka ardhur disa herë në Shqipëri. Jam në dijeni nga burimi i sipërpërmendur se me ardhjen e tij në Shqipëri ai (i ndjeri S. A. ka ndihmuar ekonomikisht vëllanë e tij M. A. duke i dhënë një shumë të konsiderueshme në kartëmonedhën dollarë amerikane.

arsyetimin e vdekjes të tij, në kuptim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016⁵¹, pasi vdekja e xhaxhait nuk kushtëzon provueshmërinë e të ardhurave të ligjshme, të deklaruara rregullisht në institucionet kompetente të vendit, ku janë përfituar të ardhurat nga xhaxhai i subjektit të rivlerësimit dhe për të cilat janë paguar tatimet në kohën e kryerjes së dhurimit.

18.7.5. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mosjustifikimit të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave, që kanë shërbyer për shlyerjen e kështit të tretë të huas në vitin 2008, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

18.7.6. Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e huas ndër vite, shtetasit P. K., si rrjedhojë ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë *banesë private e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë, me sipërfaqe ndërtimi 105 m²*, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

19. Për pasurinë truall me sipërfaqe 200 m², ndodhur në lagjen nr. {*}, Sarandë, mbi të cilën është ndërtuar banesë private e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë me sipërfaqe ndërtimi 105 m²**

19.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk qëndron argumentimi i Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit për mënyrën e përfitimit të truallit, pasi sipas tij e ka fituar atë, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.12.1998, me palë shitëse E. N. dhe dhënë pëlqimi K. N.. Sipas subjektit, në vendimin gjyqësor të datës 07.04.1999, në të cilin ai ka qenë në cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues, vetëm i është njohur e drejta kërkuesve për të rivendosur në afat, pra, për të paraqitur kërkesë para ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim KKKP) dhe ky vendim është dhënë pas lidhjes së kontratës së shitblerjes së truallit.

19.2. Trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin përkatës, konstatoi se Komisioni ka kërkuar informacion mbi origjinën e kësaj prone dhe në përgjigje, ASHK-ja Sarandë (ish-ZVRPP-ja), me shkresën nr. {***} prot., datë 09.08.2019, ka dërguar historikun⁵² e kësaj pasurie. Me vendimin e datës 07.04.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, vendim ku subjekti i rivlerësimit ka pasur cilësinë e kryesuesit të trupit gjyqësor, është vendosur rivendosja në afat të së drejtës të shtetasit K. N., për paraqitjen e dokumentacionit në ish-KKKP, duke i dhënë kështu këtij të fundit, nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 18.01.2000, të KKKP-së, të drejtën për të

⁵¹ Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.

⁵² Nga administrimi i së cilës, lidhur me origjinën e saj, ka rezultuar se me nr. {***} akti dhe nr. {***} vendimi, datë 27.8.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, shtetasve K. dhe E. N. u është njohur e drejta e pronësisë mbi një shtëpi banimi dhe sipërfaqe truall prej 1615 m², ndodhur në lagjen nr. {***}, Sarandë. Me kontratën e shitblerjes⁵² datë 10.12.1998, këta shtetas i kalojnë subjektit të rivlerësimit sip. 200 m² truall, nga truall i mësipërm dhe më pas shtetas K. N. i është drejtuar gjykatës duke kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës për paraqitjen e dokumentacionit në ish-KKKP për kthimin e truallit me sipërfaqe prej 1615 m².

përfitur ligjërisht kthimin e truallit me sipërfaqe 1615 m², nga e cila sipërfaqja prej 200 m², disponohej nga vetë subjekti i rivlerësimit të cilën e kishte përfitur prej këtyre shtetasve.

Një fakt tjetër që tregon problematikat e kësaj prone dhe interesin e subjektit të rivlerësimit në marrjen e vendimit gjyqësor të datës 07.04.1999, në favor të shtetasit K. N., është mosregjistrimi i sipërfaqes truall prej 200 m² nga ZVRPP-ja Sarandë, duke detyruar subjektin e rivlerësimit t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë⁵³, nëpërmjet padisë me objekt regjistrimin e kontratës së shitblerjes të datës 10.12.1998.

19.3. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e subjektit, dokumentacionin e administruar, referuar nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”⁵⁴, vendimit nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese⁵⁵, si dhe nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile që parashikon se: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim”, çmon se ushtrimi i funksionit të subjektit, si gjyqtar në gjykimin e kësaj çështjeje dhe veprimet e tij si gjyqtar, nuk bazohen në ligj dhe në fakte, për sa provohet interesi direkt i tij për pasurinë objekt gjykimi, subjekti i rivlerësimit duhej të hiqte dorë nga çështja objekt shqyrtimi, për arsye se ka pasur interesa në çështjen që ka trajtuar dhe këto interesa kanë qenë personale me karakter ekonomik. Trupi gjykues i Kolegjit, arrin në konkluzionin se, për sa i përket mënyrës së përfitimit të truallit 200 m², subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për të marrë masa, me qëllim shmangien në çdo rast të arsyeve që cenojnë garantimin e paanshmërisë në kryerjen e funksionit të gjyqtarit, si dhe etikën si një element i domosdoshëm në përmbushjen e rregullt të detyrës parashikuar kjo nga neni 41, pika 7 e ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

19.4. Lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë truall me sipërfaqe 200 m², subjekti i rivlerësimit pretendon se ka shërbyer huaja e dhënë nga vëllai i tij Xh. A., i cili i ka të ardhurat e siguruara nga puna në emigracion. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e marra hua nga vëllai janë krijuar para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, dhe nuk ka mundur të sigurojë dokument tjetër, që vërteton këto të ardhura, por vetëm deklaratën⁵⁶ e shtetasit grek N. S., për shkak se dokumentet fiskale në shtetin grek ruhen për një periudhë 10-vjeçare.

19.5. Në vendimin objekt shqyrtimi, lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se deklaratat e lëshuar nga shtetasi N. S., për të provuar punësimin e z. Xh. A., nuk provon se të ardhurat e vëllait

⁵³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. {***} dhe nr. {***} regj. datë 20.11.2007, ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e ZVRPP-së Sarandë të regjistrojë kontratën e shitblerjes, për sipërfaqen e truallit prej 200 m².

⁵⁴ “Konflikti i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësinë e tij publike”.

⁵⁵ “[...] Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizike dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike [...]”.

⁵⁶ Deklaratë, datë 02.10.2019, e cila ka konfirmuar marrëdhëniet e punës së vëllait të tij në shtetin grek, për periudhën 1993 – 2002, me pagën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) dhrahmi/muaj dhe për periudhën 2002 – 2008 me pagën 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro.

të subjektit janë të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa nuk provojnë pagesën e tatimeve për këto të ardhura. Deklarata e lëshuar nga shtetasi N. S., ku deklarohet punësimi i z. Xh. A. në vitet 2005 – 2008, nuk mbështetet nga verifikimet e sistemit *TIMS*, sipas të cilave nuk rezulton që ky i fundit të ketë kryer udhëtime nga Greqia në Shqipëri dhe anasjelltas. Në përfundim, Komisioni⁵⁷ konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësinë e personit tjetër të lidhur, shtetasit Xh. A., për të mbuluar me burime të ligjshme huan dhe, rrjedhimisht, nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të blerjes së pasurisë së paluajtshme truall, si dhe ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me burimin e krijimit të saj.

19.6. Në këtë kuadër nga verifikimi i akteve të fashikullit të përcjellë nga Komisioni, trupit gjykues i rezulton se në deklaratën e pasurisë “*vetting*” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *sipërfaqe truall 200 m², në shumën 600.000 (gjashtëqind) mijë lekë, në Sarandë, blerë me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 10.12.1998, nga shitësja E. N.. Pasuri me nr. {***}, z. k. {***} referuar vërtetimit hipotekor, datë 20.10.2009, lëshuar nga ZVRPP-ja Sarandë. Kjo shumë lekësh për blerjen e truallit më është dhënë hua nga vëllai im Xh. A., i cili i ka siguruar këto të ardhura nga emigracioni në Greqi. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 05.07.2015. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2016.*

Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar tokën truall prej 200 m² ndodhur në Sarandë. Subjekti i rivlerësimit, duke filluar nga deklarimi periodik vjetor i vitit 2003 dhe deri në vitin 2016, nuk ka deklaruar huan e marrë të vëllait Xh. A. apo shlyerjen e saj me qëllim blerjen e truallit. Kjo hua është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit vetëm në deklaratën e pasurisë “*vetting*” dhe në deklaratën periodike të vitit 2017. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar para ILDKPKI-së dy deklarata noteriale⁵⁸ lëshuar nga shtetasit Xh. dhe M. A..

19.7. Detyrimi ligjor i subjektit për të deklaruar pasuritë dhe detyrimet ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin në deklaratat periodike vjetore të çdo pasurie, duke përfshirë edhe detyrimet monetare ndër vite. Neni 32 i ligjit nr. 84/2016, parashikon shprehimisht se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, kanë detyrimin të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Detyrimi i parashikuar në pikat 1 dhe 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtrihej mbi të ardhurat e vëllait të tij Xh. A., person tjetër i lidhur, që rezultonte huadhënës në favor të subjektit të rivlerësimit.

19.8. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003 i truallit prej 200 m², ndodhur në Sarandë, përfituar me kontratën e shitblerjes të datës 10.12.1998, si dhe mosdeklarimi në deklaratat periodike vjetore, duke filluar nga viti 2003 e më pas, i huas së marrë në vitin 1998 nga vëllai i tij Xh. A., me qëllim blerjen e truallit të sipërcituar, në kushtet kur shoqërohen me pamjaftueshmëri të burimit të ligjshëm të krijimit të tyre, konsiderohen si veprime me qëllim fshehjen e pasurisë, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 32 pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësinë e personit tjetër të lidhur, shtetasit Xh. A.,

⁵⁷ Paragrafi 58.10, faqe 21, i vendimit të Komisionit.

⁵⁸ Në deklaratën e parë nr. {***}, datë 05.7.2015, shtetasi Xh. A deklaroi se i ka dhënë subjektit shumën prej 600.000 (gjashtëqind mijë) lekësh për blerjen e sipërfaqes 200 m², ndërsa në deklaratën e dytë nr. {***}, datë 27.12.2016, përcaktonte se këtë shumë ia ka dhënë pa interes dhe pa afat.

për të mbuluar me burime të ligjshme huan dhe, rrjedhimisht, nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të blerjes së pasurisë së paluajtshme truall, duke e vendosur atë në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

19.9. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, për pasurinë banesë private e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë me sipërfaqe ndërtimi 105 m², si dhe për pasurinë truall me sipërfaqe 200 m², të ndodhur në lagjen nr. {***}, Sarandë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe gjendet për këto pasuri në kushtet e fshehjes së parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e këtij ligji.

20. Lidhur me depozitë në bono thesari në shumën 3.000.000 (tre milion) lekë

20.1. Komisioni ka vlerësuar se për sa shuma 2.700.000 lekë,(e përfituar nga shitja e banesës në Delvinë dhe pretenduar nga subjekti si burim për krijimin e depozitës), nuk është deklaruar gjendje *cash* në fund të vitin 2004, sikurse e kërkon ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ajo nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për pasurinë e luajtshme likuiditete në bono thesari në vitin 2012.

20.2. Subjekti pretendon se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, por dhe në procesverbalin e datës 01.11.2004 të mbajtur në ILDKPKI, ka përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar shitjen e shtëpisë në Delvinë, në shumën 2.700.000 lekë, si dhe fakti që ka provuar pagimin e tatimit për kontratën e shitjes në shumën 27.000 lekë, konform legjislacionit në fuqi, sipas tij, kjo e ardhur është burim i ligjshëm i krijimit të depozitës bankare në Bankën e Shqipërisë si bono thesari.

20.3. Gjatë hetimit administrativ në Komision rezultoi se, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.2.2019, Banka e Shqipërisë konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka çelur depozitë bono thesari në shumën 3.000.000 (tre milion) lekë, në datën 13.12.2012. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “*vetting*” ka deklaruar se burimi kryesor i krijimit të kësaj shume është nga shitja e shtëpisë në Delvinë, në shumën 2.700.000 (dy milion e shtatëqind mijë) lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 300.000 (treqind mijë) lekësh e ka burimin nga depozita bankare (shuma 900.000 nëntëqind mijë lekë) e krijuar nga punësimi i dy bashkëshortëve. Në deklaratën e interesave private të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga sa ka deklaruar në deklaratën “*vetting*”, ka deklaruar si burim për krijimin e depozitës të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë.

20.4. Në kushtet kur të ardhurat e përfituara nga shitja e shtëpisë në Delvinë, afektojnë pasurinë depozitë bono thesari në shumën 3.000.000 (tre milionë) lekë të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar në Komision për këtë pasuri, nga ku rezulton se:

20.4.1. Me kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 03.05.2004, subjekti i rivlerësimit i ka shitur shtetasit B. H. pasurinë e paluajtshme banesë ndodhur në Delvinë, Sarandë, kundrejt vlerës 2.700.000 (dy milion e shtatëqind mijë) lekë. Aktmarrëveshje nr. {***} rep., datë 03.05.2004, e lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit B. H. me objekt përcaktimin e modaliteteve të shlyerjes së çmimit.

20.4.2. Deklaratë e pasurisë “vetting”, në të cilën subjekti ka deklaruar se *shtëpia e banimit në Delvinë, me sipërfaqe trualli 474 m² e përbërë nga 4 (katër) dhoma, korridor, banjë, verandë në vlerën 2.500 (dy mijë e pesëqind) lekë është ndërtuar me kontribut bashkëshortor para vitit 1990. Leja e ndërtimit është dhënë më datë 07.06.1988 nga ish-Këshilli Popullor i qytetit Delvinë në emër të shtetasit Petrit Aliaj. Shtëpia e banimit në Delvinë është shitur me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 03.05.2004, në shumën 2.700.000 (dy milion e shtatëqind mijë) lekë.*

20.4.3. Deklaratë e interesave periodike të vitit 2004, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *shtëpinë e banimit në Delvinë e kam shitur te shtetasi B. H. me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., në vlerën 2.700.000 (dy milion e shtatëqind mijë) lekë.*

20.4.4. Procesverbalin datë 29.05.2015, të mbajtur para ILDKPKI-së, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat nga shitja e banesës në Delvinë, në shumën 2.700.000 (dy milion e shtatëqind mijë) lekë, blerësi ia ka dhënë me vonesë, me sa i kujtohej atij në vitin 2011 ose 2012, për shkak të vështirësive ekonomike.

20.5. Në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, mbi periudhën e përfitimit të shumës nga shitja e shtëpisë Delvinë, trupi gjykues çmon se kjo shumë është përfituar në vitin 2004, bazuar kjo në dokumentacionin e ndodhur në dosje, konkretisht në: (a) kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 03.05.2004, me shtetasin B. H., kontratë e cila referuar parashikimeve të nenit 690 të Kodit Civil ka forcën e ligjit për palët dhe pasojat që ajo sjell; (b) parashikimet e aktmarrëveshjes me nr. 155 rep., datë 3.5.2004⁵⁹; (c) deklarinimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, deklaratë të cilat referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji gjatë procesit të rivlerësimit; dhe (ç) mandatar-këtimin nr. {***}, datë 20.05.2004, paraqitur nga subjekti⁶⁰, për pagimin e tatimit për vlerën e plotë të shumës së përfituar nga shitja e banesës.

Në nenin 9 të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, “Për kontabilitetin”, parashikohet, ndër të tjera, *se çdo dokument kontabël mbështetet në një dokument justifikues (fillestar) dhe kërkesat e formës dhe të vlefshmërisë të dokumenteve justifikuese për t’u pranuar për regjistrime në kontabilitet, përcaktohen me regjimet kontabël, si dhe referuar “Sistemit kontabël të përgjithshëm”, pika 2.2, “Rregullat e përgatitjes së dokumenteve justifikuese”, dokumenti justifikues bazë përgatitet në kohën kur kryhet veprimi, sipas kësaj dispozite, mandatpagesa merr një rëndësi të veçantë në vërtetimin e faktit të kohës së kryerjes së pagesës së tatimit të kalimit të pasurisë së paluajtshme. Për gjithë sa trajtuar më lart, trupi gjykues arrin në konkluzionin se shuma e përfituar nga subjekti i rivlerësimit nga shitja e banesës në Delvinë i përket vitit 2004.*

20.6. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim kontradiktor për burimin e krijimit të depozitës në vlerën 3.000.000 lekë në vitin 2012, në Bankën e Shqipërisë, pasi në deklarinimin periodik vjetor të vitit 2012, si burim për krijimin e depozitës është deklaruar se shërbyen të ardhurat e mbajtura *cash* në banesë të përfituara nga ushtrimi i profesionit të

⁵⁹ Sipas kësaj marrëveshjeje, parashikohet se shuma prej 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekësh është paguar në datën e lidhjes së saj, ndërsa pjesa tjetër prej 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekësh do të likuidohej brenda datës 08.08.2004.

⁶⁰ Vërtetim nr. {***}, datë 13.09.2019, i ASHK-së Sarandë [...] rezulton se z.Petrit Aliaj, ka paguar tatimin në shumën 27.000 lekë [...].

avokatisë (të ardhura të cilat nuk u provuan se janë të krijuara nga një burim i ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, trajtuar në paragrafin 18.5.6 të vendimit), ndërkohë në deklaratën e pasurisë “*vetting*” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shërbyen si burim të ardhurat e krijuara nga shitja e shtëpisë në Delvinë.

20.7. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se, referuar gjendjes së fakteve dhe rrethanave si më sipër konstatuar, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë, në përputhje me ligjin, burimin për pasurinë e sipërcituar, gjithashtu vëren se të ardhurat e përfituara nga shitja e shtëpisë në Delvinë në vitin 2004, në raport me krijimin e depozitës në vitin 2012, kanë një distancë të gjatë kohore (periudhë rreth 8-vjeçare), si dhe duke konsideruar faktin se ato nuk janë deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2004, si dhe në deklaratat periodike të viteve pasardhëse, vlerëson se gjendja e likuiditeteve *cash* nuk mund të provohet ndryshe në këtë proces, përveç se me deklaratat periodike, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie që mund ta provojë atë.

20.8. Kolegji, në vijim të qëndrimit të mbajtur⁶¹, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete *cash* në deklaratën vjetore të vitit 2004 e në vijim, likuiditete *cash* të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit se kanë shërbyer, si burim i mundshëm i krijimit të pasurisë depozitë në bono thesari, nuk ka njohur dhe as ka llogaritur këtë gjendje të pretenduar prej subjektit si një e ardhur që mund të përdoret si burim 8 (tetë) vjet më vonë, për pasurinë e luajtshme likuiditete në bono thesari krijuar në vitin 2012. Në përfundim, për këtë shkak ankimi, trupi gjykues i Kolegjit, për pasurinë depozitë në bono thesari në shumën 3.000.000 (tre milion) lekë, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

21. Për pasurinë “*automjet tip MNV Pajero*”, Mitsubishi, në pronësi të L. A. (djali të subjektit të rivlerësimit)

21.1. Komisioni ka arritur në përfundimin se nuk u arrit të provohet burimi i ligjshëm i krijimit të pasurisë së luajtshme, automjet, nga djali i subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që për të ardhurat nga punësimi i tij nuk provohet pagimi i detyrimeve tatimore, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për dhënie kohë shtesë për paraqitjen e dokumentacionit që lidhet me punësimin e djalit të tij në Greqi, Komisioni⁶², duke konstatuar se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të ndikojë në vonesën e procesit e tij të rivlerësimit, e vlerësoi të panevojshme, bazuar në nenin 49/6/a e ligjit nr. 84/2016, si dhe referuar deklarimeve⁶³ të subjektit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i pyetur për këto të ardhura.

⁶¹ Vendim nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019, paragrafi 43; vendim nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, paragrafi 32.5; vendim nr. 29/2019 (JR), datë 08.11.2019, paragrafi 31; vendim nr. 1/2020 (JR), datë 15.01.2020, paragrafi 50; vendim (JR) nr. 11/2019, paragrafi 27; vendim (JR) nr. 19/2019, paragrafët 84-85; vendim (JR) nr. 20/2019, paragrafi 59; vendim (JR) nr. 20/2020, paragrafi 19.4; vendim (JR) nr. 12/2021; vendim (JR) nr. 27/2020, paragrafët 19.4.iii, 19.4.v.

⁶² Paragrafët 72.2 dhe 72.3, faqe 28, i vendimit të Komisionit.

⁶³ Procesverbali i mbledhjes së zhvilluar më 10 shkurt 2017, në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë bërë publik në media, ku i pyetur për të ardhurat e djalit të tij në shtetin grek, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Djali im L. A. ka shkuar çdo verë për vite me radhë te kushërinjtë e tij të parë në shtetin Grek, të cilët janë emigrantë ekonomikë në Greqi, duke punuar dhe ai si emigrant ekonomik. Djali im ka punuar në detyrën e ‘bodyguard’ nëpër kazino nate, pa pasur leje punësimi si të shumica e emigrantëve të tjerë ekonomikë shqiptarë, në punë të zeza, duke rrezikuar edhe jetën”.

21.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se rezulton e provuar burimi i ligjshëm i të ardhurave për blerjen e këtij automjeti, pasi shuma prej 7.500 eurosh e përfituar nga puna e djalit të tij në Greqi konfirmohet nga deklarata e datës 06.12.2015 e shtetasit A. M. (punëdhënësit të djalit të tij). Përmbushja e detyrimeve tatimore para shtetit grek nga punëdhënësi A. M. dhe bashkëshortja e tij A. M. provohen me dokumentacionin e tërhequr nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Greqisë për periudhën tatimore 2007-2009, të cilat kërkon të merren në cilësinë e provës, pasi, sipas tij, ka qenë i pamundur dorëzimi i këtyre akteve në Komision për shkak të kohës së pamjaftueshme të vënë në dispozicion.

21.3. Nga analizimi i akteve të dosjes, trupi gjykues konstaton se, me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 26.10.2009, djali i subjektit të rivlerësimit L. A. ka blerë automjetin tip MNV (Pajero) marka Mitsubishi, në vlerën 7.000 euro, për të cilin ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga puna e kryer gjatë pushimeve verore në vitet 2008-2009, në Greqi. Lidhur me të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga punësimi në Greqi, Komisioni, pasi kreu verifikimet⁶⁴ në sistemin e lëvizjeve të hyrje-daljeve të djalit të subjektit të rivlerësimit, i rezultoi se L. A. ka kryer lëvizje drejt shtetit grek vetëm për pak ditë përgjatë vitit 2008-2009.

21.4. Ky automjet është deklaruar nga personi i lidhur, djali i subjektit, në deklaratën e pasurisë “vetting”, si vijon: *“Automjet tip MNV Pajero, marka Mitsubishi blerë nga L. A. me kontratën nr. {***} rep., {***} kol., datë 26.10.2009, i regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Sarandë. Leja e qarkullimit rrugor {***}, datë 02.04.2012. Të ardhurat janë siguruar nga puna e kryer gjatë pushimeve verore gjatë viteve 2008 dhe 2009 në shtetin fqinj Greqi, i punësuar kam qenë te shtetasi A. Dh. M.. Deklaratë me përgjegjësi ‘Për çdo institucion shtetëror’, datë 05.12.2015, e shtetasit A. M. e kryer para Policisë së Atikës Perëndimore Greqi. Të ardhurat e punësimit 7.500 euro janë shpenzuar për blerjen e automjetit tip MNV Pajero dhe për shpenzime personale”*.

Në deklaratën e interesave periodik të vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *“Automjet tip MNV Pajero, marka Mitsubishi lloji autoveturë blerë nga L. A., me kontratën nr. {***} rep., {***} kol., datë 26.10.2009. Shumën prej 7.000 eurosh e ka nxjerr djali nga të ardhurat që ka punuar në shtetin Grek në pushimet verore”*.

21.5. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provës të dokumentit *“deklaratë tatimore lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Greqisë për periudhën tatimore 2007-2009, për shtetasin A. M. dhe A. M.”*, paraqitur bashkë me ankimin, trupi gjykues, referuar dokumentacionit të administruar gjatë zhvillimit të procedurës administrative në Komision, konstaton se subjekti ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për paraqitjen e akteve në Komision, madje rezulton se disa herë Komisioni ka marrë parasysh⁶⁵ kërkesën e subjektit për shtyrjen e afatit për paraqitjen e dokumentacionit. Në një vështrim *prima facie* të këtij akti, trupi gjykues vëren se dokumenti i paraqitur mund të vërtetojë se shtetasit A. M. dhe bashkëshortja e tij A. M. kanë qenë regjistruar si subjekt tatimor në shtetin grek dhe kanë

⁶⁴ Për vitin 2008, ka vetëm një dalje nga kufiri shqiptaro-grek, datë 04.07.2008, pa datë kthim; në datën 21.12.2008 ka udhëtuar në drejtim të Italisë nga pika kufitare e Rinasit; ndërsa për vitin 2009 ka daljeje nga kufiri shqiptaro-grek në datën 13.3.2009 dhe kthimin më 23.3.2009; ka dalë sërish në datën 23.6.2009 dhe është kthyer më 13.7.2009, lëvizje këto të provuara vetëm për pak ditë.

⁶⁵ E-mail datë 18.09.2019, Komisioni drejtuar subjektit rivlerësimit [...Në lidhje me kërkesën tuaj për shtyrje të afatit, trupi gjykues pranoi kërkuesin tuaj, duke vendosur një afat të ri në datën 18.09.2019...].

paguar rregullisht detyrimet tatimore të biznesit të tyre, por ky fakt nuk provon pagesën e kryer në vlerën 7.500 euro, djalit të subjektit të rivlerësimit, aq më tepër dhe pagimin e tatimit për këtë shumë. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se është e panevojshme marrja e kësaj prove, në kuptim të nenit 49, pika 6/a e ligjit nr. 84/2016.

21.6. Lidhur me verifikimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë “*automjet tip MNV Pajero*”, në vitin 2009, në emër të L. A., djalit të subjektit të rivlerësimit, (të ardhura të pretenduara të fituara nga puna sezonale në Greqi), trupi gjykues vlerëson se deklarata⁶⁶ e datës 06.12.2015 e shtetasit A. M. (në cilësinë e punëdhënësit të L. A.) është e pamjaftueshme për të vërtetuar përfitimin e shumës nga personi i lidhur, djali i subjektit të rivlerësimit, duke marrë në konsideratë edhe faktin e konstatuar gjatë hetimit administrativ në Komision se pas verifikimeve të lëvizjeve hyrje-dalje në sistemin *TIMS* të L. A., drejt shtetit grek për periudhën 2008-2009, ka rezultuar se kanë qenë lëvizje për periudha të shkurtra kohore.

21.7. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor përfitimin e të ardhurave të djalit të tij nga punësimi në shtetin grek, deklarin e tyre në organin kompetent, si dhe pagimin e tatimeve për këto të ardhura, ato nuk mund të klasifikohen si të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 dhe nenit 32, pikat 1 dhe 4 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arrin në përfundimin se për pasurinë “*automjet tip MNV Pajero*”, Mitsubishi, në pronësi të djalit të subjektit L. A., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

22. Lidhur me shpenzimet e shkollimit për personat e lidhur, R. dhe M. A. (vajzat e subjektit të rivlerësimit)

22.1. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e shkollimit të vajzave R. dhe M. A., pasi nuk ka provuar burimet e ligjshme të shpenzimeve të shkollimit të tyre në ShBA⁶⁷.

22.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se shpenzimet e shkollimit të vajzës R. A. janë mbuluar nga punësimi i saj në ShBA, si dhe me ndihmën e xhaxhait të subjektit, z. S. A.. Lidhur me të ardhurat e siguruar nga punësimi i vajzës së tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën me datë 03.03.2020 të R. A., në të cilën deklaroi pamundësinë e sigurimit të dokumentacionit tatimor para vitit 2011, shkresë e cila është konfirmuar edhe nga zyra për shërbimet e biznesit dhe të licencimit me vulën apostile përkatëse. Lidhur me pamundësinë e paraqitjes së dokumentacionit që provojnë të ardhurat e xhaxhait të tij S. A., subjekti i rivlerësimit paraqet të njëjtat argumente të paraqitura për justifikimin e huas marrë nga babai i tij.

⁶⁶ Deklaratë me përgjegjësi e shtetasit A. M., e përkthyer me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 6.12.2015, akt në të cilin shtetasi A. M. deklaroi se z. L. A. ka punuar për llogari të tij për dy vjet, me shpërblim total në vlerën 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro. Shlyerja e plotë e detyrimit është bërë në vitin 2009.

⁶⁷ Paragrafi 82, faqe 35, i vendimit të Komisionit.

22.3. Bazuar në sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit në ankimin e paraqitur, në deklaratën e pasurisë “vetting⁶⁸” të vajzës R. A. dhe në shpjegimet e dhëna në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ⁶⁹, në Komision, mbi burimin e të ardhurave të pretenduara për shpenzimet e shkollimit të vajzave të tij, trupi gjykues analizozi dokumentacionin e administruar nga ku rezultoi se:

22.3.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzime studimi, qëndrimi në ShBA, të vajzës së tij R. A., në deklaratën periodike të interesave në vitin 2004 dhe në vijim. Nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor për të vërtetuar faktin se të ardhurat e xhaxhait të tij S. A. kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të vajzës së tij, të ardhura këto të analizuar në paragrafin 18.7.2 të këtij vendimi, për të cilat nuk u vërtetua ligjshmëria e tyre, në kuptim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

22.3.2. Vetëdeklarimin⁷⁰ e znj. R. A. para autoriteteve amerikane, për pamundësinë e gjetjes së informacionit lidhur me të ardhurat e siguruar nga punësimi i saj para vitit 2011, trupi gjykues e konsideron të pamjaftueshëm në përpjekjet e subjektit të rivlerësimit për të paraqitur dokumentacion justifikues për të ardhurat nga punësimi. Për sa më lart, subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

22.3.3. Në përfundim të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shpenzimet e shkollimit znj. R. A. dhe gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

22.4. Lidhur me shpenzimet e shkollimit të vajzës tjetër të subjektit, znj. M. A., subjekti i rivlerësimit pretendon se për shpenzimet e shkollimit të saj, fillimisht ka shërbyer huaja prej 35.000 USD, marrë shtetasit O. L. më datë 25.07.2016, hua e cila është shlyer tërësisht në datën 07.09.2016, nga një pjesë e shumës prej 14.000 USD dhuruar nga shtetasi A. B. Xh. dhe pjesa tjetër nga huaja e marrë në shumën 25.000 euro nga shtetasi N. P..

⁶⁸ Në deklaratën e pasurisë “vetting”, vajza e subjektit të rivlerësimit R. A. ka deklaruar; “Kam ndjekur studimet tek universiteti i quajtur “{***}”, në qytetin New Jersew, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë periudhës 2004-2008. Pajesa e studimeve ka qenë si më poshtë:

viti akademik 2004-2005, USD 14.786.000 (katërmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë dollarë); viti akademik 2005-2006, USD 9.833.40 (nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre dollarë e dyzet cent); viti akademik 2006-2007, USD 8.031.50 (tetë mijë e tridhjetë e një dollarë e pesëdhjetë cent); viti akademik 2007-2008 USD 8.010.00 (tetë mijë e dhjetë dollarë).

“[...] Shpenzimet e studimeve janë paguar nga unë me anë të ndihmës prej xhaxhait të babait tim S. A.. Kjo ndihmë më është dhënë dorazi gjatë vizitës në New York. Gjithashtu, pjesë e shpenzimeve të mësipërme janë paguar nga unë me anë të të ardhurave personale gjatë kohës që kam studiuar dhe kam mbajtur pozicione të ndryshme të përshkruara në tabelën e mësipërme “Angazhime dhe veprimtari private/publike [...]”.

⁶⁹ Në përgjigje të rezultateve të hetimit paraprak, si dhe në ankimin e paraqitur në Kolegji, subjekti paraqet të njëjtat argumente, lidhur me shpenzimet e studimit dhe qëndrimin të vajzës së tij R. A. në ShBA, duke pretenduar se janë nga punësimi i saj, si dhe të ardhurat nga xhaxhai tij S. A., por gjendet në pamundësi për të paraqitur dokumentacion mbi këto shpenzime.

⁷⁰ Dëshmi datë 3 mars 2020 e dhënë nga R. A. para noterit J. H. (noter i New York,) në lidhje me punësimin dhe të ardhurat e saj. Në pjesën e fundit të këtij vetëdeklarimi të dhënë R. A. shprehet: “Ju lutem, vini re se të dhënat e Regjistrimeve Tatimore përpara vitit 2011 nuk ruhen dhe nuk vihen në dispozicion nga Shërbimi i Brendshëm i Inspektimeve”. Certifikuar/vërtetuar nga zyra e shtetit të New York për Shërbimet e Biznesit dhe Licencimeve.

22.5. Në deklaratën e pasurisë “vetting”, vajza e subjektit të rivlerësimit M. A. ka deklaruar: “Në vitin 2016 kam përfituar shumën prej 14.000 (katërbëdhjetë mijë) dollarë amerikan në formën e dhurimit nga shtetasi A. B. Xh., sikundër rezulton nga deklarata noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 10.09.2016 dhe deklarata, datë 10.12.2016, e shtetasve A. dhe M. Xh.. Burimi i kësaj shume është pjesërisht shumë 7.000 (shtatë mijë dollarë) nga kursimet e pensionit të pleqërisë (vërtetimet nr. {***} prot., datë 17.10.2016, e Degës së Sigurimeve Shoqërore Sarandë dhe pjesa tjetër në shumën 7.000 (shtatë mijë) dollarë e ka burimin nga dhurata që shtetasi A. Xh. e ka nga djali i tij M. Xh., këtë shumë e ka sjellë në Shqipëri A. Xh. kur ka ardhur në vitin 2016. Marrje hua nga z. N. P. dhe M. P. në shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, fakt i cili rezulton nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.05.2016. Kjo shumë e ka burimin nga aktiviteti i ligjshëm i biznesit të vogël bufe, që shitësja M. P. (bashkëshortja e shtetasit N. P.) ka ushtruar me NIPT {***}, në fshatin {***}, Sarandë, në vitet 2009,2010,2011,2012,2013,2014 dhe 2015, ku për këto të ardhura është paguar tatimi mbi të ardhurat konform ligjit në fuqi. Shuma e huas prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro nga z. N. P. dhe një pjesë e shumës prej 14.000 (katërbëdhjetë mijë) dollarë amerikanë të dhuruar nga shtetasi A. Xh. kanë shërbyer për kthimin e huas prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) USD të marrë shtetasit O. L. më datë 25 korrik 2016, duke e shlyer në këtë mënyrë detyrimin ndaj këtij të fundit [...]”.

22.6. Me deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 25.07.2016, shtetasi O. L. konfirmon⁷¹ dhënien e huas në shumën prej 35.000 USD, znj. M. A. dhe me deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 07.09.2016, konfirmon⁷² kthimin e saj.

22.7. Me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për pagimin e shpenzimeve të studimit të vajzës së tij M. A., trupi gjykues analizoi dokumentacionin ligjor mbi vlerat e përfituara nga subjekti në formën e dhurimit dhe huas, si më poshtë.

22.7.1. Lidhur me dhurimin e shumës prej 14.000 USD, të pretenduar nga subjekti se i është dhuruar nga shtetasi A. Xh. vajzës së tij R. A., me qëllim përballimin e studimeve të saj në ShBA, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se me deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 10.09.2016, shtetasi A. Xh. konfirmon dhënien e shumës prej 14.000 dollarësh M. A., ndërsa me deklaratën e datës 10.12.2016⁷³ shtetasit A. dhe M. Xh. konfirmojnë të njëjtin fakt, duke dhënë

⁷¹ Z. O. L. deklaron se: “[...] shtetasja M. A. ka marrë një hua prej meje në vlerë monetare 35.000 dollarë amerikan, të cilat do të shërbejnë për të paguar studime universitare jashtë shtetit në ShBA. Ne deklaruesit kemi rënë dakord që kjo vlerë monetare do të kthehet prej deklaruases në momentin e përfundimit të studimeve Universitare, studime që do të kryhen jashtë shtetit marrja hua e kësaj vlere monetare do të kryhet në datën 25.07.2016 nëpërmjet kalimit të sistemit bankar [...]”.

⁷² Shtetasi O. L. deklaron se: “... deklaroj se shtetasja Marjana Aliaj ka likuiduar totalisht detyrimin monetar, detyrim që rrjedh nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2016. Deklaroj se nga ky moment shtetasja Marjana Aliaj nuk ka më asnjë detyrim monetar ndaj meje [...]”.

⁷³ Në deklaratën, datë 10.12.2016, hartuar para noterit publik z. A. O. të shtetit të New Jersey, z. A. Xh., ka deklaruar se: “[...] nga shuma prej 14.000 dollarë të dhuruar R. A. një pjesë të saj konkretisht shumën prej 7.000 dollarë e ka siguruar nga pensioni i tij që përfiton në Shqipëri, ndërsa pjesën tjetër prej 7.000 dollarësh ia ka dhënë dhuratë djali i tij M. Xh., i cili e ka të siguruar nga punësimi i tij në ShBA, pasi ai dhe familja e tij jetojnë prej 20 vitesh në ShBA. Djali i tij M. Xh. konfirmon në të njëjtën deklaratë se i ka dhënë babait të tij A. Xh. shumën prej 7.000 dollarësh të

shpjegime edhe mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre. Subjekti ka paraqitur në Komision vërtetimin e datës 05.12.2016, me anë të të cilit vërtetohet se shtetasi M. Xh. është i punësuar prej vitit 2002 në kompaninë “{***}” si teknik shërbimi dhe vërtetimin nr. {***} prot., datë 17.10.2016, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Sarandë, në të cilin vërtetohet se z. A. Xh. përfiton pension pleqërie në masën mujore 10.060 lekë.

22.7.2. Në analizë të dokumentacionit më sipër, trupi gjykues çmon se vërtetimi nr. {***} prot., datë 17.10.2016, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore Sarandë, vetëm konfirmon masën e pensionit që përfiton shtetasi A. Xh., por nuk konfirmon tërheqjen e pensionit dhe dhënien e shumës prej 7.000 dollarësh personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit M. A., ndërsa lidhur me pagesën e shumës prej 7.000 euro nga A. Xh., si burim të ardhurat e djalit të tij M. Xh., konstatohet se vërtetimi i datës 05.12.2016 tregon vetëm punësimin e djalit të A. Xh.t. Subjekti nuk paraqiti dokumentacion justifikues mbi mënyrën e dhënies të kësaj shume vajzës së tij dhe sjelljen e tyre nga ShBA në Shqipëri, nga shtetasi A. Xh..

22.7.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankimin e paraqitur mbi konstatimin e Komisionit⁷⁴ mbi mënyrën e dhënies dhe kalimit të kësaj shume nga A. Xh. te vajza e subjektit M. A., me argumentin se këto shuma janë marrë dorazi nga vajza e tij, e cila ka qenë disa herë në ShBA në atë periudhë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit se për sa kohë nuk u vërtetua burimi i krijimit të ligjshëm të këtyre shumave të pretenduara të marra në formën e dhuratës nga A. Xh., si dhe nuk u vërtetua me dokumentacion ligjor justifikues kalimi i këtyre shumave e, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, bazuar vetëm në deklaratatë të kryera në funksion të procesit të rivlerësimit, mbeten vetëm në kuadrin deklarativ dhe, si të tilla, të paprovuara.

22.7.4. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se të ardhurat nga dhurimi i shumës prej 14.000 dollarësh kanë shërbyer për shpenzimet e shkollimit të vajzës së tij M. A., mbetet i pabazuar në fakte dhe prova në kushtet kur subjekti nuk arriti t’i justifikojë ato me dokumentacion ligjor, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit, në kushtet e nenit 32, pika 1 dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

22.7.5. Lidhur me verifikimin e mundësisë financiare të z. N. P. dhe znj. M. P. për dhënien e huas në vlerën 25.000 euro, Komisionit i rezultoi se të ardhurat e personave të tjerë të lidhur (N. dhe M. P.) nga aktiviteti privat ishin në vlerën prej 5.980.610 lekësh, duke mos marrë në konsideratë investimet që ata mund të kenë kryer, si dhe i rezultoi se shuma e fitimit *neto* është më e ulët se shpenzimet jetike për familjen e personave të tjerë të lidhur (huadhënësve), të cilat për këtë periudhë rezultojnë në vlerën 7.047.110 lekë. Komisioni vlerësoi se personat e tjerë të lidhur N.

siguruar nga puna e tij në Amerikë dhe është në dijeni të faktit se këtë shumën ia ka dhuruar të afërmes së familjes së tyre M. A. [...]”.

⁷⁴ *Në faqen 42 të vendimit: “Trupi gjykues e gjen të paarsyeshëm edhe shpjegimin e dhënë nga subjekti edhe rrjedhën e ngjarjeve, sipas të cilave vlerat monetare të fituara në ShBA u transportuan në Shqipëri për t’ju dhuruar vajzës së subjektit, e cila do të duhej t’i transportonte këto vlera përsëri në ShBA për t’i përdorur gjatë shkollimit. Nëse individët, shtetas amerikane, me banim në ShBA kishin vendosur të ndihmonin vajzën e subjektit për shpenzimet e shkollimit të saj, mund ta bënin duke mundësuar këtë sasi të hollash në ShBA, në vendin ku ata banonin dhe ku do të shkollohej edhe vajza e subjektit, pa kryer transaksionet vajtje-ardhje të vlerave të konsiderueshme monetare të cilat ngrenë dyshime mbi vetë vlefshmërinë e transaksioneve”.*

dhe M. P., nuk kanë pasur mjete financiare të ligjshme që mund të shërbenin për huan e dhënë në shumën 25.000 euro në vitin 2016.

22.7.6. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke iu referuar akteve të paraqitura gjatë hetimit administrativ në cilësinë e provës, shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 18.10.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë⁷⁵, si dhe shkresës nr. {***} prot., datë 24.10.2016, të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Sarandë⁷⁶.

22.7.7. Me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare të N.dhe M. P., në cilësinë e personit tjetër të lidhur me personin e lidhur, znj. M. A., trupi gjykues shqyrtoi dokumentacionin e administruar nga ku rezultoi:

- Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 09.05.2016, shtetasi N. P. konfirmon dhënies e huas në vlerën 25.000 euro për garanci për vizën amerikane znj. M. A., duke mos përcaktuar afat kohor për kthimin e saj.

- Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 29.10.2016, shtetasja M. P. deklaron se është bashkëshortja e N. P. dhe shpreh dakordësinë për dhënien e huas prej 25.000 eurosh, pa interes dhe pa afat znj. M. A.. Në këtë deklaratë noteriale znj. M. P. jep shpjegime për burimin e ligjshëm të të ardhurave të saj që burojnë nga aktiviteti i saj tregtar “{***}”.

22.7.8. Në analizë të deklarimeve më sipër, trupi gjykues konstaton se ka kontradikta në deklarime lidhur me arsyet e përfitimit të kësaj huaje, pasi në deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 09.05.2016, shtetasi N. P. deklaron si qëllim të dhënies së kësaj shume si garanci për vizën amerikane, kurse në ankimin e paraqitur në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo hua ka shërbyer për shlyerjen e huas shtetasit O. L. në shumën prej 35.000 dollarësh.

22.7.9. Kolegji nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të shtetasve N. dhe M. P., për dhënien e huas personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, znj. M. A., kreu përllogaritjet bazuar në tabelën përmbledhëse⁷⁷ të detyrimeve tatimore vendore nga viti 2006 deri në vitin 2016 të biznesit person fizik “M. P.”, me aktivitet “{***}”, me NIPT {***}, si dhe mbështetur në deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale⁷⁸ për vitet 2009-2015 të këtij aktiviteti. Nga analiza ekonomiko- financiare⁷⁹ rezultoi se personat e tjerë të lidhur, N dhe M. P., nuk kanë pasur mjete financiare të ligjshme që mund të shërbenin për dhënien e huas në vitin 2016, e cila pretendohet nga subjekti i rivlerësimit se ka shërbyer për shkollimin e vajzës së tij M. A..

22.7.10. Në konkluzion të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se lidhur me shpenzimet e shkollimit të personave të lidhur të subjektit, R. dhe M. A. (vajzat e tij), subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për përballimin

⁷⁵ Në këtë shkresë janë paraqitur të ardhurat e deklaruara pranë organit tatimor për periudhën 2009-2015, të personit fizik “{***}”, me aktivitet “{***}” me NIPT {***}.

⁷⁶ Në këtë shkresë paraqiten në formë tabelare detyrimet tatimore vendore nga viti 2006-2016, të personit fizik “{***}”.

⁷⁷ Shkresa nr. {***}, datë 24.10.2016, e Drejtorisë së Taksave Vendore të Bashkisë Sarandë.

⁷⁸ Shkresa nr. {***}, datë 18.10.2016, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë.

⁷⁹ Kjo përllogaritje u krye mbi aktet sipërcituara të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Komision për provueshmërinë e të ardhurave të personave tjetër të lidhur huadhënësve N. dhe M. P..

e shpenzimeve të shkollimit, duke e vendosur atë në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

23. Për pasurinë tokë arë me sipërfaqe 712 m² ndodhur në {*}, Tiranë, regjistruar në emër të K. A., bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit**

23.1. Komisioni ka vlerësuar se çmimi prej 50.000 lekësh, për sipërfaqen 300 m² i përcaktuar në kontratën e shitjes nr. {***}, datë 25.06.2002, duket i sforcuar dhe shumë larg vlerës reale të tregut, duke ngritur dyshime të arsyeshme se çmimi i blerjes së pasurisë së paluajtshme nga subjekti i rivlerësimit është fiktiv. Komisioni ka arritur në përfundimin⁸⁰ se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me çmimin e blerjes prej 250.000 lekësh në total për sipërfaqen 712 m².

23.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se çmimi i përcaktuar në kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.06.2002 dhe në kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.08.2002, përfaqëson, pikërisht, vlerën e shitjes së tokës mbi bazën e vullnetit reciprok të palës blerëse dhe palës shitëse. Dyshimi i Komisionit për çmim fiktiv të blerjes së kësaj pasurie bie ndesh me parimin e kondratiktoritetit (neni 20 i Kodit të Procedurës Civile) dhe me parimin e vlerësimit dhe çmuarjes së provave në proces (neni 29 i Kodit të Procedurës Civile). Sipas subjektit, në momentin e lidhjes së kontratave, tokat arë kanë qenë në gjendje kënetë dhe ferra, gjithashtu, nuk kishte dalë ende ndonjë akt ligjor apo nënligjor për përcaktimin e vlerës së çmimit të tokës bujqësore në zonën {***}, Tiranë.

23.3. Në deklaratën e pasurisë “vetting”, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Blerje tokë arë gjithsej 712 m² në ish-fshatin {***}, Tiranë, nga ku 300 m², sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 25.06.2002, në vlerën 50.000 (pesëdhjetë) mijë lekë dhe 412 m², sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.08.2002, në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë. Shuma prej 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh e ka burimin nga shuma prej 245.000 (dyqind e dyzet e pesë mijë) lekësh e siguruar nga të ardhurat e përfituara nga shtetasi Petrit Aliaj, në muajin maj të vitit 2000, muaj në të cilin ka përfutuar pagën neto të papaguar në shumën 259.055 lekë, në zbatim të vendimit nr. 230, datë 18.02.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë [...].* Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklaram të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar sipërfaqen totale prej 712 m², ndërsa në rubrikën “Burimi” ka deklaruar vetëm kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.06.2002, me atë të së cilës ka përfutuar truallin prej 300 m², në fshatin {***} dhe nuk ka deklaruar kontratën tjetër të shitblerjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 12.08.2002, me anë të së cilës ka përfutuar truallin me sipërfaqe 412 m², në këtë deklaram subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar çmimin e blerjes dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

23.4. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konstatimi i Komisionit, se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për çmimin⁸¹ e blerjes prej 250.000 lekësh në total për sipërfaqen 712 m², mbetet i pavërtetuar, për sa kohë subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit *vetting* ka deklaruar çmimin e referuar dhe të përcaktuar në kontratat e shitblerjes.

⁸⁰ Paragrafi 68.3, në faqen 25, të vendimit të Komisionit.

⁸¹ Vlera prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekësh për blerjen e truallit me sipërfaqe 300 m² dhe vlera prej 200.000 (dyqind mijë) lekësh për blerjen e truallit prej 412 m².

24. Depozitë në vlerën 2.000.000 (dy milion) lekë, datë 18.03.2013, në Bankën e Shqipërisë

24.1. Komisioni arriti në përfundimin⁸² se nuk u arrit të provohet burimi i ligjshëm i krijimit të depozitës në vlerën 2.000.000 (dy milion) lekë, për sa kohë që për të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes në vitet 2010, 2011 dhe 2012, (që pretendohen se kanë shërbyer si burim krijimi për këtë depozitë) nuk u provua, pagimi i detyrimeve tatimore, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

24.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e bashkëshortes së tij, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës në vlerën 2.000.000 lekë, datë 18.03.2013, në Bankën e Shqipërisë, provohen me vërtetimet e datës 04.07.2015⁸³ dhe datës 05.01.2017⁸⁴ të lëshuara nga administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, z. E. Sh., me NIPT {***}. Sipas subjektit pagesa mujore, nga punëdhënësi shoqëria “{***}” ShPK te punëmarrësi K. A., është kryer dorazi dhe të gjitha detyrimet tatimore janë kryer nga shoqëria. Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore⁸⁵, ku pasqyrohet pagesa e kontributeve nga ana e “{***}” ShPK në favor të bashkëshortes së tij, përkatësisht për vitet 2010, 2011 dhe 2012 dhe vërtetimi nr. {***} prot., datë 13.06.2019, i Degës së Sigurimeve Shoqërore Sarandë, janë akte zyrtare me fuqi të plotë provuese, në kuptim të nenit 246 e vijues, 253 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, akte të cilat, sipas tij, konfirmojnë se K. A. ka qenë e punësuar në periudhën 2010-2012, pranë shoqërisë “{***}” ShPK.

Në analizë të vendimit të Komisionit, akteve në fashikull dhe shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, siç shtjellohet në vijim, nuk arritën të zhbëjnë sa konstatohet nga aktet që përbëjnë provë. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj depozite. Në vijim shtjellohen aktet dhe analiza e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit për këtë shkak ankimi: (i) me shkresën nr. {***} prot., datë 20.2.2019, Banka e Shqipërisë konfirmon se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka çelur depozitë në bono thesari në shumën 2.000.000 (dy milion) lekë, në datën 26.3.2013, me afat njëvjeçar, të cilën e ka riinvestuar edhe për një vit tjetër në datën 25.3.2014; (ii) në deklaratën e pasurisë “vetting” bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“Depozitimi i shumës 2.000.000 (dy milion) lekë te Banka e Shqipërisë Dega Gjirokastër më datë 18.03.2013. Kjo shumë lekësh e ka burimin kryesor nga punësimi i shtetasës K. A. te subjekti “{***}” ShPK, Sarandë gjatë periudhës 2010-2012. Në vitin 2010 është përfituar paga 700.000 (shtatë qind mijë) lekë/vit, në vitin 2011 është përfituar paga mujore 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë/vit, në vitin 2012 është përfituar paga 500.000 (pesëqind mijë) lekë/vit”*. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortes së tij, subjekti i

⁸² Paragrafi 69.11, faqe 27, i vendimit të Komisionit.

⁸³ Vërtetojmë se K. Sh. A. është e punësuar te firma “{***}” ShPK, me administrator z. E. Sh., e cila ka filluar punë pranë kësaj firme në vitin 2010 dhe ka marrë si pagë vjetore 700.000 lekë në vit. Për vitin 2011 ka si pagë mujore 60.000 lekë në muaj, për vitin 2012 ka si pagë vjetore 500.000 lekë në vit. Saktësoj faktin se për këto vite që ka qenë në punë janë paguar dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

⁸⁴ Me anë të së cilës vërtetojmë se shtetasja K. Sh. A. ka qenë punonjëse e subjektit juridik “{***}” ShPK dhe gjatë vitit 2013 ka përfituar pagën neto 216.280 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë, gjatë vitit 2014 ka përfituar pagën neto 271.508 (dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetë) lekë.

⁸⁵ Në ankimin e paraqitur, subjekti ka pretenduar se ka dorëzuar në Komision, librezën e punës së bashkëshortes në cilësinë e provës, nga verifikimi u konstatua se librezja e dorëzuar mban shënimin “librezë kontributesh për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”.

rivlerësimit ka kryer deklaratimet përkatëse në deklaratat⁸⁶ e interesave periodike të viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013.

24.2.1. Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga paga e bashkëshortes së subjektit të deklaruar në deklaratën e interesave periodik të vitit 2010 dhe 2011, si dhe deklaratën e pasurisë “vetting”, trupi gjykues, pas analizimit të informacionit bankar të gjendur në fashikujt e administruar, konstatoi se është kryer kalimi i pagës për znj. K. A., në vitin 2010, nëpërmjet “ProCredit Bank”, vetëm për vlerën 86.126 lekë, mungon informacioni bankar që të provojë kalimin e pagesave për pagë për vitin 2011, si dhe mungon dokumentacioni justifikues ligjor për pagesën e detyrimeve tatimore në këtë vit për vlerat e pretenduara dhe të deklaruar si të përfituara nga paga e bashkëshortes, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kërkesat e nenit 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016. Lidhur me të ardhurat e përfituara për vitin 2012, referuar shkresave⁸⁷ të ISSH-së ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se janë deklaruar të ardhura neto në total, vetëm për vitin 2012, në shumën 69.184 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekë, nga punësimi i znj. K. A. në shoqërinë “{***}” ShPK.

24.2.2. Lidhur me dokumentin “librezë kontributesh për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, nëpërmjet së cilës subjekti kërkon të vërtetojë pagën e përfituar nga bashkëshortja e tij, konstatohet se në të pasqyrohen të dhëna për derdhjet nga muaji maj i vitit 2010 deri në dhjetor të vitit 2012. Në rubrikën “subjekti që paguan” është vendosur emri i shoqërisë “{***}” ShPK, shoqëruar me NIPT-in e shoqërisë. Në rubrikën “muaji shuma e derdhur” është vendosur vlera e derdhur, në krah të së cilës është vendosur firmë dhe vulë, por vula nuk identifikohet të jetë në emër të shoqërisë, pasi është e palexueshme.

Referuar të dhënave që përmban kjo librezë, trupi gjykues vëren se për vitin 2010, nga muaji korrik deri në muajin nëntor, për secilin muaj janë paguar kontribute në vlerën 22.320 lekë, vlerë e cila konsiderohet tejet e lartë në referim të nenit 9, të ligjit 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet

⁸⁶ Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Bashkëshortja K. A. është e punësuar të firma ‘{***}’ ShPK që në datën 01.03.2010 dhe aktualisht, ka një pagë mujore 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj. Bashkangjitur dhe vërtetimi. Nga punësimi ka nxjerr të ardhura 700.000 (shtatëqind mijë) lekë të cilat i ka të rezervuara”.

Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Bashkëshortja K. A. është e punësuar të firma ‘{***}’ ShPK që në datën 01.03.2010 dhe aktualisht sot, të gjithë pagën vjetore bashkëshortja ime K. A. e ka konvertuar në euro dhe e ka depozituar ne ‘Raiffeisen Bank’, në shumën 5000 euro”.

Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Bashkëshortja K. A. është e punësuar te firma ‘{***}’ ShPK, që në datën 01.03.2010 dhe aktualisht sot, të gjithë pagën vjetore bashkëshortja ime K. A. në shumën 500.000 lekë e ka tërhequr mënjane në shtëpi. Në muajin dhjetor ka tërhequr nga ‘Raiffeisen Bank’ shumën 5.000 euro, për ta depozituar në Bankën e Shqipërisë, dega Gjirokastër, pasi ka interesa të larta, aktualisht e ka në shtëpi”.

Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Të gjithë pagën vjetore bashkëshortja ime K. A. në shumën 216.280 lekë të reja e ka tërhequr mënjane në shtëpi. Më datë 18.03.2013 ka depozituar në Bankën e Shqipërisë, dega Gjirokastër 2 milion lekë të reja dhe ka tërhequr interesat në datë 21.05.2013, në vlerën 114.380 lekë. Ka në llogarinë e ‘Raiffeisen Bank’ shumën 200.000 lekë të depozituara të mbledhura nga viti 2010,2011 dhe 2012 nga puna e saj.

Në rubrikën e dokumentacionit justifikues subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Dokumentacioni i punësimit ndodhet pranë Degës Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Sarandë”.

⁸⁷ Shkresa nr. {***} prot., datë 19.02.2019, e ISSH-së dhe shkresa nr. {***} prot., datë 12.07.2017.

shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar⁸⁸, si dhe referuar VKM-së nr. 477, datë 30.06.2010⁸⁹, në të cilën përcaktohet se paga maksimale për llogaritjen e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore deri më 27.07.2011, është 84.100 lekë.

Për sa më sipër, sigurimi shoqëror dhe shëndetësor në masën 11.2%, nuk do të mund të kalonte vlerën 9.419 lekë, si rrjedhojë, vlera 22.320 lekë e pasqyruar në librezën e kontributeve nuk mund të jetë në asnjë rrethanë vlerë kontributesh shoqërore dhe shëndetësore, sikurse paraqitet në këtë librezë, fakt ky që vë në dyshim besueshmërinë e të dhënave që përmban kjo librezë.

Në të njëjtin konkluzion, trupi gjykues arrin dhe për të dhënat e pasqyruara në këtë librezë për vitin 2011, në të cilën për muaj të caktuar janë pasqyruar vlera të larta kontributesh, kësaj referuar VKM-së së sipërcituar, kontributi për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011, nuk mund të kalonte vlerën 9.419 lekë dhe për gjashtëmuajorin e dytë të vitit, nuk mund të kalonte vlerën 9.822 lekë.

Për sa më lart, nga të dhënat që përmban librezat e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitur nga subjekti, nuk provohet që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka përfituar atë të ardhur të deklaruar dhe të pretenduar, si dhe librezat ka të dhëna jo të sakta dhe jo të plota, mbi pagesat e kontributeve të një marrëdhënie pune, përkundrajt një page të caktuar.

24.2.3. Vërtetimet e lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK, për konfirmimin e marrëdhënies së punësimit të bashkëshortes së subjektit, jo vetëm që nuk provojnë pagimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura me qëllim klasifikimin e tyre si të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, por përbëjnë një vlerë kufizuese provuese, duke marrë në konsideratë informacionin⁹⁰ e përcjellë Komisionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit Parave, mbi lidhjen e interesave ekonomike-financiare që kanë familjarët e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “{***}” ShPK. Subjekti bazuar në parashikimet e nenit⁹¹ 12 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, duhet të provonte ekzistencën e një marrëdhënie juridike pune midis shoqërisë dhe bashkëshortes së tij, nëpërmjet një kontrate pune apo akte të tjera, të cilat provojnë ekzistencën/përmbushjen e elementëve të detyrueshëm të një marrëdhënie të tillë.

24.2.4. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se dokumentacioni justifikues ligjor i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar përfitimin e pagës nga bashkëshortja e tij në shoqërinë “{***}” ShPK, është i pamjaftueshëm. Shumat e kaluara nëpërmjet sistemit bankar, konkretisht 86.126 lekë për

⁸⁸ [...] kontributi shoqëror dhe shëndetësor nuk mund të përcaktohet nën një pagë minimale dhe mbi një pagë maksimale mujore të cilat përcaktohen me VKM [...].

⁸⁹ (a) sigurimi shoqëror llogaritet në masën 9.5% kundrejt pagës bruto, vetëm nëse paga bruto është më e ulët se paga maksimale, e përcaktuar me VKM; (b) në rastet kur paga bruto është më e madhe se paga maksimale, sigurimi shoqëror në masën 9.5% llogaritet kundrejt pagës maksimale; (c) sigurimi shëndetësor në masën 1.7% llogaritet gjithmonë kundrejt pagës bruto.

⁹⁰ Shkresa nr. {***} prot., datë 22.01.2019, në të cilën është konstatuar një veprim në llogarinë bankare të datës 31.01.2011, me përshkrimin dërgues: “M. A. (babai i subjektit të rivlerësimit) në vlerën 2.000.000 lekë kalon në favor të ‘{***}’ ShPK., likuidim situacioni”.

⁹¹ Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim.

vitin 2010 dhe 69.184 lekë për vitin 2012, megjithëse të llogaritura nga Komisioni si e ardhur në mungesë të dokumentacionit, që vërteton pagesën e detyrimit tatimor, mbeten të papërfillshme për krijimin e depozitës në vlerën 2.000.000 lekë dhe, për rrjedhojë, kjo e ardhur nuk mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e depozitës në vlerën 2.000.000 lekë.

24.2.5. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë justifikuar me të ardhura financiare të ligjshme krijimin e depozitës në vlerën 2.000.000 (dy milion) lekë, datë 18.03.2013, në Bankën e Shqipërisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

25. Lidhur me shumën 50.000 USD të kaluara në llogarinë e djalit të subjektit të rivlerësimit, z. L. A.

25.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se huaja e marrë në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) USD është përdorur si garanci për efekt të vizës për në ShBA dhe është kthyer brenda një afati shumë të shkurtër, 10-ditor. Subjekti i rivlerësimit e vërteton këtë fakt me deklaratën noteriale të datës 16.01.2017, të lëshuar nga shtetasi A. G., si dhe kërkon të merret në cilësinë e provës fotokopje e pasaportës të djalit të tij L. A. me vizën amerikane të marrë nga Ambasada Amerikane në periudhën në fjalë.

Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni e ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, pasi, sipas tij, detyrimi ligjor është të deklarojnë çdo lloj detyrimi financiar (hua) që është krijuar dhe ekziston brenda vitit kalendarik dhe nëse ai është shuar nuk ekziston detyrimi ligjor i subjektit për të kryer deklarimin. Sipas subjektit neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikonte detyrimin për të deklaruar në deklaratën “*vetting*” marrëdhëniet e huamarrjes, vetëm nëse ato ekzistojnë në momentin e formulimit të kësaj deklaratë. Lidhur me mundësitë financiare të shtetasit A. G., subjekti i rivlerësimit shpjegon se z. G. ka qenë administrator i shoqërisë “{***}” dhe në periudhën në fjalë është njohur si biznesmen korrekt në marrëdhëniet e detyrimeve tatimore me shtetin.

25.2. Nga analizimi i dokumentacionit bankar ka rezultuar se në datën 27.11.2008, shtetasi A. G. ka kaluar për llogari të djalit të subjektit, L. A. shumën 50.000 USD dhe në datën 02.12.2008 është bërë tërheqje e kësaj shume në “Alpha Bank” nga L. A.. Lidhur me këtë transaksion, shtetasi A. G. ka lëshuar deklaratën noteriale nr. {***}, datë 16.01.2017, sipas së cilës konfirmon depozitimin në llogari të djalit të subjektit, L. A. shumën prej 50.000 USD, e cila është shlyer në datën 02.12.2008 (dhënë dorazi).

25.3. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se shuma prej 50.000 dollarësh, kaluar nga shtetasi A. G. në llogarinë bankare të djalit të subjektit të rivlerësimit pranë “Alfa Bank” në datën 27.11.2008, nuk është deklaruar në deklaratën e interesave periodike të vitit 2008, si dhe në deklaratën e pasurisë “*vetting*”. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shuma prej 50.000 dollarësh ka shërbyer si garanci për marrjen e vizës amerikane dhe se kjo vlerë është kthyer brenda vitit 2008, trupi gjykues çmon se ky fakt nuk provohet me asnjë dokumentacion ligjor provues, kthimi i kësaj shume shtetasit A. G.. Deklarata noteriale nr. {***}, datë 16.01.2017, e z. A. G., i cili konfirmon kthimin e kësaj shume dorazi nga L. A. në datën 02.12.2008, e kryer gjatë periudhës së rivlerësimit, përbën një akt me fuqi të kufizuar provuese e kryer për efekt të procesit të rivlerësimit rreth 9 (nëntë) vjet më vonë nga kryerja e transaksionit dhe, si e tillë, nuk mund të

provojë se tërheqja e shumës prej 50.000 dollarësh nga djali i subjektit të rivlerësimit ka shërbyer për dorëzimin e saj shtetasit A. G..

25.4. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se ai nuk kishte detyrimin për deklarimin e kësaj shume, pasi nuk u arrit të vërtetohet me dokumentacion justifikues ligjor se shuma prej 50.000 dollarësh e tërhequr nga llogaria bankare nga djali i subjektit të rivlerësimit t'i jetë kthyer shtetasit A. G.. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 4, shkronjat “d”⁹² e “dh”⁹³ të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, kishte detyrimin ligjor të deklaronte në deklaratën e interesave periodike të vitit 2008, tërheqjen e saj dhe destinacionin e përdorimit të shumës së sipërcituar, të deklaronte në deklaratën e pasurisë “*vetting*”, shumën e kaluar në llogarinë bankare të personit të lidhur me të, nga një person i tretë, bazuar në parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 3, pika 11, 30-32 dhe shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

25.5. Lidhur me dokumentin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit “*kopje e pasaportës së djalit të tij L. A.*”, të cilin kërkon të administrohet si provë, trupi gjykues konstaton se në të gjendet vizë e lëshuar nga Ambasada e ShBA-së, në Shqipëri, më datë 03.12.2008 dhe çmon se ky akt nuk provon rrethanën e paraqitur nga subjekti për të vërtetuar qëllimin për të cilin është marrë kjo shumë e konsiderueshme në monedhën dollarë. Për sa sipër, dokumentin (fotokopje e pasaportës), trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson si mjet tërësisht të papërshtatshëm për të provuar sa pretendon subjekti dhe, si i tillë, nuk përmbush kushtet për t'u administruar si provë, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe nenit 49, pika 6, shkronjat “a” e “c” të ligjit nr. 84/2016.

26. *Lidhur me shumat e marra hua gjatë viteve 2004, 2005, 2006 dhe 2007, nga shtetasi O. L.*

26.1. Komisioni arriti në përfundimin⁹⁴ se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm, në lidhje me këto transaksione, për vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

26.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se shumat e depozituara në bankë dhe të tërhequra brenda vitit kalendarik janë marrë hua shtetasit O. L. në valutën euro dhe konvertuar në dollarë si garanci për nxjerrje vizash për në ShBA, për vajzën R. A.. Bashkëlidhur ankimit ka vënë në dispozicion fotokopje të pasaportës të vajzës së tij, R. A., në të cilën pretendon se janë vizat e marra nga Ambasada e ShBA-së, gjatë viteve 2004, 2005, 2006 dhe 2007, që kërkon të merret në cilësinë e provës. Lidhur me shlyerjen e kësaj huaje, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***}, rep., {***} kol., datë 28.08.2007, të deklaruesit O. L..

26.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, lidhur me këtë shkak ankimi, rezulton se me deklaratën noteriale⁹⁵ nr. {***} rep., {***} kol., datë 28.08.2007, shtetasi O. L. konfirmon faktin e dhënies

⁹² “Vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”.

⁹³ “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”.

⁹⁴ Paragrafi 81.8, faqe 34, i vendimit të Komisionit.

⁹⁵ “Unë deklaruesi i kam dhënë shtetasit Petrit Aliaj, për të depozituar si garanci bankare, në emrin e tij me afat njëmuor pranë Degës Bankare ‘Tirana Bank’ ShA, Sarandë, vlerat: më datë 14.06.2004 i kam dhënë shtetasit Petrit

së shumave subjektit të rivlerësimit dhe kthimin përsëri brenda një afati një mujor, me argumentin se i janë i dhënë vetëm për t'u përdorur si garanci për marrjen e vizave për në ShBA. Konstatohet se shumat e sipërcituara nuk janë deklaruar në deklaratat e interesave periodike vjetore të viteve 2006, 2007 dhe në deklaratën e pasurisë “vetting”.

Trupi gjykues i Kolegjit, duke marrë në analizë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se shumat e depozituara në bankë dhe të tërhequra brenda vitit kalendarik janë marrë hua shtetasit O. L. në valutën euro dhe konvertuar në dollarë si garanci për nxjerrje vizash për në ShBA për vajzën R. A., por pa i shoqëruar me asnjë provë ligjore këto pretendime, konstaton se nuk provohet marrja, destinacioni apo kthimi e këtyre të ardhurave, shtetasit O. L..

26.4. Për sa i përket shpjegimeve dhe provave të subjektit për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të shtetasit O. L., referuar dokumentacionit të sjellë në cilësinë e provës, vërtetimin e lëshuar nga Zyra Vendore Arsimore Sarandë, për të provuar punësimin e bashkëshortes së tij, znj. L. L., si arsimtare, trupi gjykues i Kolegjit, ashtu si dhe Komisioni, vlerëson se të ardhurat e referuara në këtë provë janë të pakonsiderueshme në krahasim me shumat e depozituara në llogaritë e subjektit dhe, në asnjë rast, nuk mund të mbulojnë burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre shumave.

Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se burimi i të ardhurave të shtetasit O. L. është i ligjshëm, pasi paratë e depozituara në këtë llogari bankare janë verifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Parave, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar, mbështetur në parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohen, detyrimet që ka subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

26.5. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për marrjen në cilësinë e provës të dokumentit “fotokopje të pasaportës me vizë e Ambasadës së ShBA-së” të vajzës së tij R. A., trupi gjykues vëren se subjekti ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për depozitim të këtij dokumenti në Komision, si dhe nuk ka dhënë ndonjë argument për të provuar pamundësinë e paraqitjes së këtij akti. Konstatohet se në të gjendet vetëm vizë e lëshuar në datën 08.07.2004 dhe në datën 20.07.2005, nga ambasada e ShBA-së, ndërsa për vitin 2006 dhe 2007, nuk rezulton të jetë paraqitur nga subjekti dokumentacion justifikues. Pavarësisht këtij fakti, trupi gjykues vlerëson se ky akt nuk vërteton rrethanën e pretenduar nga subjekti se kalimi i shumave monetare në valutën euro në llogari të tij kanë qenë për qëllim garancie bankare për pajisje me vizë amerikane. Për sa sipër, ky dokument (fotokopje e pasaportës) është tërësisht i papërshtatshëm për të provuar qëllimin për të cilin e pretendon subjekti rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk përmbush kushtet për t'u

Aliaj 29.650 (euro) me afat njëmuajor, për të cilën është bërë konvertimi në vlerën prej 36.000 USD, vlerë e cila është dhënë po për garanci bankare dhe po kjo vlerë më është kthyer prej shtetasit Petrit Aliaj; më datë 20.07.2005 i kam dhënë po me afat njëmuajor 20.000 euro (njëzet e pesëmijë euro); më datë 28.07.2006 i kam dhënë po me afat njëmuajor shumën 19.500 euro; më datë 25.07.2007 i kam dhënë po me afat njëmuajor, shumën 15.000 euro. Këto vlera të cituara sipas viteve 2004, 2005, 2006 dhe 2007, të cilat ia kisha dhënë hua për garanci bankare shtetasit Petrit Aliaj nuk kam pretendime, për faktin se kanë qëndruar si Depozitë Garancie dhe kanë kaluar pas afateve njëmuajor, po në favorin tim, pra, të O. L. [...]”.

administruar si provë, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe nenit 49, pika 6, shkronjat “a” e “c” të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor për destinacionin dhe kthimin e shumave shtetasit O. L., trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm, në lidhje me këto transaksione, për vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

27. Lidhur me denoncimet e ardhura në Komision

27.1. Nga aktet në fashikull rezulton se në Komision janë regjistruar denoncimet nr. {***}, datë 16.12.2017 dhe nr. {***}, datë 30.07.2018, i shtetasës B. S., si dhe denoncimi nr. {***}, datë 05.04.2018, i shtetasit K. M. N., në të cilat janë raportuar të dhëna për pasuri të fshehura nga subjekti i rivlerësimit, një ndër to edhe pallati 7-katësh, pasuri të cilat janë vënë në emër të babait dhe vëllait të subjektit të rivlerësimit.

27.2. Pas hetimit të kryer, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në dokumentacionin e hetimit administrativ, Komisionit i rezultoi se vëllai dhe babai i subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur burime të ligjshme për të financuar ndërtimin e pasurisë objekt denoncimi. Komisioni⁹⁶ vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimet e ligjshme të pasurisë të personave të tjerë të lidhur me të, si dhe nuk arriti t'i provojë trupit gjykues se nuk gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84.2016, që lidhen me fshehjen e pasurisë, në funksion të shmangies së kontrollit nga organet e rivlerësimit të këtyre pasurive.

27.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon se me shtetasen B. S. është në armiqësi që nga viti 2002, fakt i ditur publikisht nga të gjithë, të cilën ia ka bërë të ditur edhe Komisionit. Ndërsa me shtetasin K. N. është në konflikt interesi, pasi ky shtetas ka qenë palë në gjykim në një çështje gjyqësore, ku subjekti i rivlerësimit në cilësinë e relatorit është shprehur me vendimin nr. {***}, datë 08.07.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Vendim, i cili ka disponuar për lënien në fuqi të vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 29.12.2016, ku ky i fundit ka disponuar për rrëzimin e padisë së paditësit K. N.. Subjekti i rivlerësimit kërkon të merret në cilësinë e provës vendimi nr. {***}, datë 08.07.2014, i Gjykatës së Apelit Vlorë, pasi për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar ka pasur vështirësi për ta kujtuar këtë fakt.

27.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se arsyetimi i Komisionit, se subjekti është person i lidhur me babanë e tij M. A. dhe vëllanë Xh. A. për pallatin që këta disponojnë, nuk qëndron, pasi ai është person i lidhur vetëm për marrëdhënien e huas dhe jo për pasuritë që ata disponojnë dhe posedojnë dhe është shkëputur nga trangu familjar i babait dhe i vëllait që në vitin 1986. Gjithashtu, subjekti pretendon se nuk ka asnjë detyrim ligjor për të provuar burimet e ligjshme të pasurisë pallat të babait të tij. Arsyetimi i Komisionit, lidhur me mundësinë financiare që kanë M. A. dhe Xh. A. për të investuar për këtë pasuri, është i gabuar, pasi këto subjekte nuk janë pjesë e këtij procesi dhe nuk kanë asnjë detyrim ligjor për të paraqitur dokumentacion justifikues.

⁹⁶ Paragrafi 85.7, faqe 37, i vendimit të Komisionit.

27.5. Lidhur me denoncimin⁹⁷ për pasuri të fshehur të objektit pallat 7-katësh nga ana e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka rezultuar se:

27.5.1. Me shkresën nr. {***} prot., datë 06.03.2019, Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Drejtoria Sarandë ka informuar se në emër të z. M. A. (babait të subjektit të rivlerësimit) figuron aplikimi për legalizimin e një ndërtimi pa leje me praktikën nr. {***} prot., datë 27.1.2015. Aplikimi është kryer në datën 27.01.2015 nga z. Xh. A., si përfaqësues i z. M. A. mbi bazën e një prokure të përgjithshme me nr. {***}, datë 02.10.2009, rezulton se ndërtimi pa leje është një pallat 7-katësh banimi, ndodhur në lagjen nr. {***}, Sarandë.

Me shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit Parave (DPPPP) ka dhënë informacion për transaksione në vlera të konsiderueshme parash të kryera në “Bankën Kombëtare Tregtare” në llogaritë e shtetasit M. A. (për periudhën 2010 – 2012), të kryera nga shtetasit M. A. apo Xh. A. me përfitues shtetasin M. A. me burim, kryesisht, të ardhura nga aktiviteti, të ardhura personale, të ardhura nga emigracioni, pra, 24 depozitime *cash* në vlerën 26.237.500 lekë dhe 12 depozitime *cash* në vlerën 135.000 euro, në llogari të M. A.. Konstatohet një veprim i datës 31.01.2011 me përshkrimin dërgues: “M. A. në vlerën 2.000.000 lekë kalon në favor të ‘{***}’ ShPK⁹⁸, *likuidim situacioni*”, me burim të ardhura.

27.5.2. Nga analiza e situatës faktike që është e provuar nga hetimi administrativ, rezulton se midis subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij ka ekzistuar një marrëdhënie dhurimi, ndërsa midis subjektit dhe vëllait të tij ka ekzistuar një marrëdhënie huamarrjeje, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që lidhej me përdorimin e këtyre shumave, përkatësisht për shlyerjen e huas dhe blerjen e truallit mbi të cilën është ndërtuar banesa e subjektit.

Trupi gjykues i Kolegjit, duke marrë në konsideratë faktin se vëllai i jepte subjektit hua në vitin 1998, për blerjen e truallit, me sipërfaqe 200 m², ndodhur në Sarandë, mbi të cilën është ndërtuar banesë private përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë me sipërfaqe ndërtimi 105 m², kontribuonte personalisht në ndërtimin e kësaj banese dhe jepte vlerën monetare 15.000 USD, për 1/3 e pjesës takuese të tij, për shlyerjen e detyrimeve monetare për ndërtimin e kësaj banese, i falte më pas subjektit pjesën takuese në këtë banesë, krijon bindjen se rrethana të tilla flasin për një marrëdhënie të pazakontë të subjektit me vëllanë e tij. Përtej marrëdhënies së huas apo dhurimit që i ka dhënë babait dhe vëllait të subjektit statusin e personit tjetër të lidhur, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni me të drejtë ka kërkuar informacion për ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë së përshkruar më sipër prej vëllait dhe babait të subjektit, në kuadër të verifikimit të dyshimeve të bëra prezente nga denoncimi i publikut i ardhur në Komision, sipas të cilit kjo është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, por e regjistruar në emër të vëllait dhe babait të tij.

27.5.3. Referuar të dhënave⁹⁹ të përcjella nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë rezulton se subjekti tregtar “{***}” e ka pasur 0 (zero) qarkullimin dhe fitimin për vitet 2010-2015. Sikurse vërehet, babai i subjektit të rivlerësimit M. A. nuk rezulton të ketë të ardhura të tjera, përveçse të

⁹⁷ Denoncimi i bërë nga shtetasi K. M. N. i regjistruar në Komision nr. {***}, datë 05.04.2018, i administruar në fashikull.

⁹⁸ Shoqëria “{***}” ShPK është shoqëria në të cilën ishte e punësuar bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit K. A..

⁹⁹ Shkresa nr. {***} prot., datë 26.02.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë e cila informon Komisionin për subjektin M. Z. A., me NIPT {***}.

ardhurat nga pensioni, pasi të ardhurat e përfituara nga dhurimi i vëllait të tij (xhaxhait të subjektit) në vitet 1992-1995 nuk u vërtetuan me dokumentacion justifikues ligjor (analizuar më lart në këtë vendim). Gjithashtu, lidhur me verifikimin e të ardhurave të vëllait të subjektit të rivlerësimit Xh. A., rezultoi se vetëm deklarata e shtetasit grek N. S. jep të dhëna rreth tyre, por nuk gjendet asnjë dokumentacion justifikues ligjor që të provojë deklarin e tyre si të ardhura të ligjshme nga emigracioni në shtetin grek. Ky fakt, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por në terma të përgjithshëm, ka qenë pjesë edhe e denoncimit nga publiku.

27.5.4. Krahas këtyre argumenteve, një informacion që mbështet dyshimet e ngritura rreth pronësisë së fshehur të pallatit 7-katësh, ndodhur në Sarandë, janë edhe të dhënat në shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2019, (DPPPP) mbi konstatimin e një veprimi të datës 31.01.2011, me përshkrimin dërgues: *“M. A. në vlerën 2.000.000 lekë kalon në favor të shoqërisë ‘{***}’ ShPK, likuidim situacioni”*, në një kohë që shoqëria *“{***}”* ShPK është shoqëria në të cilën ishte e punësuar bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit K. A., fakt ky që përforcon argumentin e paraqitur në denoncim. Kjo e dhënë vlen të përmendet si një rrethanë që simbolizon në dukje marrëdhënien që ka subjekti i rivlerësimit me këtë pasuri.

Në përfundim, lidhur me denoncimin e paraqitur në Komision, për pasuri të fshehur të objektit pallat 7-katësh, ndodhur në Sarandë, duke analizuar konkluzionet e mësipërme në raport me njëra-tjetrën, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

28. Kolegji, në një vlerësim tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr.84/2016, çmon se subjekti i rivlerësimit, për qasjen dhe sjelljen e tij ndaj procesit të rivlerësimit, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, gjendet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, duke plotësuar në këtë mënyrë një nga rastet e parashikuara për shkarkimin e tij nga detyra dhe, për pasojë, vendimi nr. 260, datë 15.06.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 260, datë 15.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Aliaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 16.11.2022.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me zgjidhjen e çështjes, me vendimin (JR) nr. 44, datë 16.11.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 260, datë 15.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Aliaj, por ndaj mendim ndryshe lidhur me dy momente që lidhen, me aspektin procedural sa i përket formës së shqyrtimit të çështjes dhe aspektin material, mbi konkluzionin e arritur për pallatin 7-katësh, ndodhur në Sarandë.
2. Sa i përket aspektit procedural, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se çështja gjyqësore duhej të zhvillohej në seancë gjyqësore publike, për shkak të plotësimit të kërkesave të nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që lidhet me konstatimin e *shkeljes së rëndë procedurale* të kryer nga Komisioni, sa i përket shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit më datë 15.06.2020. Nuk jam dakord me arsyetimin e shumicës në paragrafin 13.2.5, të vendimit, pasi kërkesa për përjashtimin e trupit gjykues duhej shqyrtuar nga një tjetër trup gjykues e Komisionit, në zbatim të nenit 75, të Kodit të Procedurës Civile, në kushtet kur për çështjen Komisioni nuk kishte shpallur vendimin përfundimtar dhe çështja në këtë fazë konsiderohet ende në shqyrtim. Në vlerësimin tim, pa dashur kurrësi të mbështes sjelljen e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, paraqitja e kërkesave të shumta dhe të vazhdueshme në adresë të trupit gjykues në Komision, çmoj se nuk justifikon këtë të metë procedurale të kryer nga Komisioni. Në këto kushte, në kuptim të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilit Kolegji mund të *korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar*, çështja duhet të ishte shqyrtuar në seancë gjyqësore publike, për të garantuar procesin e rregullt ligjor, të drejtën e subjektit dhe mos cenimin e vendimit.
3. Lidhur me pasurinë në lagjen nr. {***}, ndodhur në Sarandë, ndaj mendim ndryshe nga shumica e trupit gjykues, që e ka konsideruar këtë pasuri në kushtet e një pasurie të fshehur nga subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Nëse do të provohej fshehja e kësaj pasurie, ajo do të përbënte kryefjalën e procesit të rivlerësimit të subjektit Petrit Aliaj. Që të konkludohet mbi faktin e një pasurie të fshehur, vlerësoj se provat duhet të flasin qartë dhe të nxjerrin në dritë këtë fakt. Nga aktet e administruara për këtë pasuri, nuk arrihet të provohet që vërtet pallati 7-katësh, në Sarandë, është një pasuri e subjektit të rivlerësimit, por e regjistruar në emër të vëllait dhe babait të tij.
4. Çmoj që gjykata disponon të gjitha mjetet ligjore për të bërë një hetim të plotë të situatës faktike, për më tepër, në kushtet e mosevidentimit të një *connecti ligjor* të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri. Po kështu, vlerësoj se babai dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit nuk mund të cilësohen si persona të tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi marrëdhëniet e huas, dhurimit në kuadër të kësaj dispozite, nuk lidhen me këtë pasuri. Aktet e administruara në këtë çështje në vlerësimin tim janë të pamjaftueshme për të mbështetur konkluzionin e shumicës për fshehje pasurie. Nuk mund të arrihet në një përfundim mbi bazë dyshimi e, për pasojë,

provueshmëria në këtë rast do të ishte e domosdoshme, gjë e cila mungoi dhe nuk u krye as në Komision dhe as në Kolegj. Për ta lidhur me aspektin procedural të trajtuar më sipër, kalimi i çështjes në seancë gjyqësore publike, vlerësoj se do të çonte në një hetim më të plotë mbi gjendjen e fakteve dhe do t'i shërbente vendimmarrjes së gjykatës lidhur me këtë pasuri.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi